



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

VENDIM

Nr. 50, datë 07.02.2024

**PËR
MIRATIMIN E “RAPORTIT VJETOR MBI VEPRIMTARINË E KOMISIONIT TË
PLANIFIKIMIT STRATEGJIK, ADMINISTRIMIT DHE BUXHETIT
PËR VITIN 2023”**


Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në pikën 16, të nenit 62 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

V E N D O S I:

1. Miratimin e “Raportit vjetor mbi veprimtarinë e Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit për vitin 2023” sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR



**RAPORTI VJETOR MBI VEPRIMTARINË
E
KOMISIONIT TË PLANIFIKIMIT STRATEGJIK,
ADMINISTRIMIT DHE BUXHETIT
PËR VITIN 2023**

PËRMBAJTJA

1. HYRJE.....	2
2. KOMPETENCAT E KOMISIONIT TË PLANIFIKIMIT STRATEGJIK, ADMINISTRIMIT DHE BUXHETIT	3
3. VEPRIMTARIA E KOMISIONIT NË SHIFRA	3
4. ARRITJET E KOMISIONIT GJATË VITIT 2023	4
5. AKTIVITETI I KOMISIONIT SIPAS FUSHAVE TË VEPRIMTARISË	6
6. PËRMIRËSIMET NË INFRASTRUKTURËN TEKNOLOGJIKE NË FUNKSION TË RRITJES SË TRANSPARENCËS, EFIÇENCËS DHE AKSESIT NË SISTEMIN GJYQËSOR	21
7. MENAXHIMI FINANCIAR NË FUNKSION TË ADMINISTRIMIT TË MIRË DHE EFIKAS TË VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT DHE GJYKATAVE	27
I. Programi buxhetor 01110, “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”, ku përfshihen fondet buxhetore për funksionimin e veprimtarisë së institucionit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.....	29
II. Programi buxhetor 01140, “Mbështetje për Teknologjinë e Sistemit të Drejtësisë”	31
III. Programi buxhetor 03310, “Buxheti Gjyqësor”, ku përfshihen fondet buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së gjykatave në të gjitha nivelet	32
8. PROJEKTE TË KOMISIONIT TË PLANIFIKIMIT STRATEGJIK, ADMINISTRIMIT DHE BUXHETIT	34
9. ANGAZHIME PËR TË ARDHMEN.....	35

1. HYRJE

Sikurse çdo vit, në përmbushje të detyrimit ligjor përcaktuar në pikën 16, të nenit 62 të Ligjit nr. 115/2016¹, Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (KPSAB) harton dhe prezanton përmbledhjen e veprimtarisë së tij vjetore. Komisioni, si një ndër strukturat e përhershme, që ndihmon Këshillin e Lartë Gjyqësor për të arritur me efikasitet dhe cilësi misionin e tij, ushtron funksione të qenësishme lidhur me planifikimin strategjik, administrimin dhe buxhetin për gjithë sistemin gjyqësor përfshirë Këshillin, Qendrën e Teknologjisë së Informacionit (QTI) dhe gjykatat e të tre niveleve.

Hartimi i raportit vjetor, krahas detyrimit ligjor, është një moment bilanci ku vlerësohen përveç arritjeve, sfidat dhe mundësitë që e ardhmja sjell në funksion të garantimit të një sistemi gjyqësor funksional dhe eficient si nga pikëpamja menaxheriale, administrative, ashtu edhe e burimeve njerëzore e financiare.

Viti 2023 është një vit transformimi për sistemin gjyqësor, për shkak të zbatimit të Hartës së Re Gjyqësore, miratuar me VKM Nr.495, datë 21.7.2022, “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”. Riorganizimi i kompetencave tokësore të gjykatave passolli një seri ndryshimesh si në aspektin ligjor ashtu edhe atë administrativ, ndryshime këto të cilat janë reflektuar në veprimtarinë e Komisionit, si struktura përgjegjëse brenda Këshillit të Lartë Gjyqësor për garantimin e mirë-funksionimit të sistemit gjyqësor nga perspektiva e administrimit financiar dhe menaxheriale dhe ajo e burimeve njerëzore.

Në fund të vitit 2023, në përputhje me dispozitat ligjore parashikuar nga neni 62 i Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” u krye dhe ndryshimi i përbërjes së Komisioneve të përhershme të Këshillit. Për rrjedhojë, kompozimi i Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit paraqitet si më poshtë:

Gjatë vitit 2023, Komisioni përbëhej nga anëtarët e poshtëpërmendur:	Me vendimin nr. 742 datë 26.12.2023, Komisioni ndryshon përbërjen:
- Znj. Naureda Llagami, Kryetare	- Znj. Naureda Llagami, Kryetare
- Znj. {...}, anëtare	- Znj. Gentiana Muçaj, anëtare
- Znj. Fatmira Luli, anëtare	- Znj. Fatmira Luli, anëtare
- Znj. {...}, anëtare zëvendësuese	- Znj. Yllka Rupa, anëtare zëvendësuese
- Znj. Yllka Rupa, anëtare zëvendësuese	- Znj. Emona Muçi, anëtare zëvendësuese

¹ I cili parashikohet se: “Brenda muajit janar të çdo viti kalendarik, secili komision i përhershëm paraqet në mbledhjen plenare të Këshillit raportin vjetor të veprimtarisë me gjetjet dhe rekomandimet përkatëse. Raporti bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit.”

2. KOMPETENCAT E KOMISIONIT TË PLANIFIKIMIT STRATEGJIK, ADMINISTRIMIT DHE BUXHETIT

Sikurse është përmendur edhe në raportet e mëparshme vjetore, kuadri ligjor² i ka atribuuar KPSAB-së kompetenca të rëndësishme në tre nivele:

- I. **Nivelin Strategjik**, në funksion të të cilit Komisioni ndërmerr iniciativa strategjike, qoftë edhe në nivele *ad hoc*, për adresimin në kohën e duhur dhe me mjetet e përshtatshme, të dinamikave të ndryshme me të cilat ballafaqohet Këshilli dhe sistemi gjyqësor.
- II. **Nivelin Administrativo – menaxherial**, kompetenca këto që lidhen me rregullimin e brendshëm të gjykatave nga pikëpamja e burimeve njerëzore, infrastrukurore dhe pasurive të paluajtshme/aseteve duke përcaktuar standardet etiko-profesionale të nëpunësve civilë gjyqësorë, me qëllim garantimin e një sistemi funksional dhe eficient.
- III. **Nivelin e politikave buxhetore dhe financiare**, funksion i cili del në pah veçanërisht gjatë procesit të përgatitjes së dokumentit të projektbuxhetit afatmesëm (PBA), negocimit dhe monitorimit të zbatimit të këtij buxheti, me qëllim jo vetëm garantimin e standardeve të menaxhimit financiar, por edhe vlerësimit të situatës financiare dhe buxhetore për sistemin gjyqësor. Në kuadër të kësaj kompetence ligjore, KPSAB-ja është përgjegjëse edhe për hartimin, miratimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave buxhetore dhe financiare në sistemin gjyqësor (KLGJ, QTI dhe gjykatat e të tre niveleve), duke garantuar burimet e nevojshme financiare në kuadër të mbarëvajtjes së funksionalitetit të vetë Këshillit, QTI-së dhe gjykatave në vend.

Nga sa më sipër, Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit luan një rol të qenësishëm në përmbushjen e misionit madhor të Këshillit të Lartë Gjyqësor në qeverisjen, mbarëvajtjen dhe miradministrimin e sistemit gjyqësor në vendin tonë.


3. VEPRIMTARIA E KOMISIONIT NË SHIFRA

KPSAB-ja, si struktura përgjegjëse në funksionin e menaxhimit të mirë e efikas të sistemit gjyqësor në vend, gjatë vitit 2023 ka realizuar 45 mbledhje, në të cilat janë marrë 119 vendime, 110 prej të cilave në fushat përkatëse të veprimtarisë si më poshtë vijon:

- 12 në fushën e planifikimit strategjik;
- 81 në fushën e administrimit dhe eficientë;
- 17 në fushën e programimit dhe menaxhimit financiar dhe buxhetor;

² Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”

Gjithashtu, 9 vendimmarrje të Komisionit i referohen miratimit të procesverbaleve të mbledhjeve plenare, në përputhje me detyrimin ligjor që ka Këshilli përkundrejt transparencës në marrëdhëniet me publikun. Përmes faqes së internetit të Këshillit, ky detyrim është përmbushur brenda afateve ligjore të arsyeshme duke kontribuar në përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies së punës së KLGJ-së përkundrejt qytetarëve dhe aktorëve të tjerë të interesuar mbi veprimtarinë e tij.



4. ARRITJET E KOMISIONIT GJATË VITIT 2023

Vendimmarrjet e Komisionit, si në numër ashtu edhe në cilësi dëshmojnë angazhim maksimal për të mundur zbatimin me sukses të projektit më madhor të Këshillit të Lartë Gjyqësor, që është zbatimi i Hartës së Re Gjyqësore. I udhëhequr nga parimet e profesionalizmit, integritetit, dhe paanshmërisë Komisioni ka vijuar punën për të garantuar përmbushjen e përgjegjësisë ligjore por njëkohësisht ka dëshmuar edhe fleksibilitet në reagimin në kohën e duhur dhe me mjetet e nevojshme ndaj problematikave të evidentuara në sistemin gjyqësor, kjo dhe në kuadrin e miratimit të Hartës së Re Gjyqësore.

Si strukturë e përhershme e Këshillit të Lartë Gjyqësor, veprimtaria e KPSAB-së është pashmangshmërisht e ndërlidhur me veprimtarinë dhe funksionin edhe të komisioneve të tjera të Këshillit, qofshin këto Komisionet e Përhershme apo edhe ato të posaçme. Ky ndërveprim evidentohet sidomos në funksion të ndërtimit të një administrate civile gjyqësore profesionale dhe arritjes së standardeve të ekselencës gjyqësore. Disa prej arritjeve më të spikatura të Komisionit janë si më poshtë vijon:

Të rëndësishme!

- ❖ 119 akte/vendime të hartuara dhe miratuara.
- ❖ Një paketë e plotë prej pothuajse 60 aktesh administrative dhe individuale, që mundësojnë zbatimin me sukses të Hartës së Re Gjyqësore për riorganizimin e kompetencave tokësore të 38 gjykata në 20 të tilla.

- ❖ Vazhdimi i zbatimit të reformës për nëpunësin civil gjyqësor³ përmes vendosjes/përcaktimit të standardeve të unifikuara të administrimit të brendshëm gjyqësor me miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë nëpër gjykata.
- ❖ Vijimi i misionit për garantimin e profesionalizimit, integritetit dhe llogaridhënies së nëpunësve civile gjyqësor përmes:
 - Zhvillimit dhe përfundimit të procedurave për verifikimin e 7 kancelarëve në detyrë;
 - Zhvillimit dhe përfundimit të procedurave për verifikimin dhe pranimin në shërbim civil gjyqësor për 4 nëpunës, 3 ndihmës ligjorë në njësinë e shërbimit ligjor në gjykatat e apeleve dhe 1 këshilltar ligjor pranë njësisë së shërbimit ligjor pranë Gjykatës së Lartë.
- ❖ Realizimi i buxhetit për sistemin gjyqësor (KLGJ-ja, QTI dhe Gjykatat) në masën 96%⁴, duke reaguar me fleksibilitet ndaj nevojave të sistemit gjyqësor në kushtet e ndryshimeve ligjore dhe administrative të imponuara nga riorganizimi i sistemit gjyqësor si dhe nga ndryshimet në kategorizimin e pagave në administratën publike.
- ❖ Vazhdimi i përpjekjeve për rritjen e transparencës, aksesit dhe besimit të publikut mbi veprimtarinë gjyqësore duke standardizuar marrëdhëniet e gjykatave me publikun dhe median përmes miratimit të udhëzuesit standard si dhe rritjes së numrit të gjyqtarëve të medias nga 8 në 17 të tillë, që mbulojnë juridiksionin e përgjithshëm dhe posaçëm për të dyja nivelet e gjykimit.
- ❖ Vijimi i angazhimit në funksion të rritjes së transparencës dhe efijencës për përdoruesit e brendshëm dhe të jashtëm të sistemeve të teknologjisë së informacionit.
 - Mundësimi i zhvillimeve të reja si dhe trajtimi i 1027 kërkesave për mbështetje teknike.
 - Përfundimi me sukses i migrimit të të gjithë bazës së të dhënave nga gjykatat që ndërprejnë veprimtarinë, për shkak të riorganizimit, në gjykatat pritëse.
 - Përfundimi i digjitalizimit të arkivës për 8 gjykata⁵.
 - Anonimizimi automatik i të dhënave sensitive në vendimet gjyqësore, duke ekuilibruar nga njëra anë nevojën e shtuar për transparencë dhe akses në gjyqësor dhe nga ana tjetrën mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

³ E cila merr zanafillën nga miratimi i vendimit “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për dhënien e statusit të nëpunësit civil gjyqësor, punonjësve në detyrë në gjykata” i vitit 2020.

⁴ Kjo përqindje raportohet nga realizimi i pritshëm i buxhetit dhe do të përditësohet pas përfundimit të rakordimit (12-mujor) me degën e thesarit Tiranë për KLGJ-në dhe me degët e thesarit në rrethe për gjykatat.

⁵ Përkatësisht: Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë; Korçë; Shkodër; Vlorë;. Zyrës së shërbimit, ish-Gjykata e Apelit Korçë; Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës; Zyrës së Shërbimit, ish Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin; si dhe Gjykatës së Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;

- Disiplinimi i procedurave të shortit me qëllim garantimin e transparencës dhe shpërndarjes së barabartë të ngarkesës së gjyqtarëve⁶.
- ❖ Funksionalizimi i Qendrës së Teknologjisë së Informacionit, përmes plotësimit të organikës së saj dhe hartimit të dokumenteve kornizë për ndërtimin e sistemit të ri të integruar të menaxhimit të çështjeve gjyqësore për të gjithë sistemin e drejtësisë.

5. AKTIVITETI I KOMISIONIT SIPAS FUSHAVE TË VEPRIMTARISË

Gjatë vitit 2023, Komisioni ka propozuar, hartuar dhe paraqitur për miratim në Këshillin e Lartë Gjyqësor akte të ndryshme të cilat kanë pasur në fokus adresimin e problematikave në nivelin strategjik, administrativ dhe financiar të vetë Këshillit si dhe sistemit gjyqësor në Shqipëri. Sikurse do të evidentohet në vazhdim të Raportit, angazhimi maksimal i KPSAB-së si nga pikëpamja voluminoze ashtu edhe substanciale është fokusuar në zbatimin e Hartës së Re Gjyqësore dhe miradministrimin e efekteve që ajo passjellë për sistemin gjyqësor.

Vendimmarrjet e KPSAB-së të realizuara gjatë vitit 2023 me funksion Planifikimin Strategjik janë si më poshtë vijon:

- ✚ **Vendimi nr. 85, datë 23.02.2023 “Për miratimin e “Raportit Vjetor mbi veprimtarinë e Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit për vitin 2022”.** I cili i shërben rritjes së transparencës së publikut.
- ✚ **Vendimi nr. 101, datë 06.03.2023 “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 280, datë 10.12.2019 “Për caktimin e gjyqtarëve për mediat” i ndryshuar.** Për shkak të riorganizimit të rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave, me qëllim garantimin e përmbushjes së detyrimit kushtetues për informimin e publikut në lidhje me veprimtaritë e gjykatës, në mënyrë të saktë, të shpejtë dhe efektive, Komisioni ka propozuar caktimin e gjyqtarëve për mediat në çdo juridiksion apeli, duke përfshirë juridiksionin e apelit të përgjithshëm, posaçëm dhe atë administrativ si dhe caktimin e gjyqtarëve për mediat në çdo gjykatë të rretheve gjyqësore.
- ✚ **Vendimi nr. 196 datë 26.04.2023 Për miratimin e “Raport mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2022”.** Ky raport, përveç pasqyrimin të veprimtarisë së kryer nga KLGJ-ja përgjatë vitit 2023 ofron një analizë krahasuese përmes indikatorëve të efikasitetit të CEPEJ, të situatës së funksionimit të sistemit gjyqësor, bazuar në të dhënat e raportuara nga vetë gjykatat.
- ✚ **Vendimi nr. 445, datë 24.07.2023 “Për miratimin e formularëve standard të**

⁶ Vendimi nr. 554, date 29.12.2022 “Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore”, <https://klgj.al/wp-content/uploads/2023/01/VENDIM-Nr.554datë-29.12.2022-PËR-NDARJEN-ME-SHORT-TËÇËSHTJEVE-GJYQËSORE.pdf> dhe vendimi nr. 724, datë 07.12.2023 “Për rindarjen me short të çështjeve gjyqësore”, <https://klgj.al/wp-content/uploads/2023/12/VENDIM-Nr.724-datë-07.12.2023-PËR-RINDARJEN-ME-SHORT-TË-ÇËSHTJEVE-GJYQËSORE.pdf>

regjistrin elektronik të organizatave jofitimprurëse". Në respektim të detyrimeve ligjore që burojnë nga Ligji nr. 80/2021 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse", Komisioni i ka propozuar Këshillit të Lartë Gjyqësor miratimin e 9 formularëve standard, të cilat do të mundësojnë funksionalitetin e plotë të platformës digjitale për organizatat jofitimprurëse brenda datës 30 dhjetor 2023. Këto formularë i janë përcjellë për mendim krahas gjykatës përgjegjëse për administrimin e këtij regjistri, që është gjykata e shkallës së parë edhe organizatave jofitimprurëse, me qëllim adresimin e problematikave apo shqetësimeve të tyre.

✚ **Vendimi nr. 505, datë 28.09.2023 "Për caktimin e një anëtari në Komisionin për Mbrojtjen e Gjyqtarëve ngritur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor"**. Ky vendim vjen si rezultat i mbarimit të mandatit 2-vjeçar të anëtarit përfaqësues të Këshillit dhe njëkohësisht edhe Kryetarit të Komisionit për Mbrojtjen e Gjyqtarëve, caktuar me vendimin e KLGJ-së nr. 361, datë 14.09.2021. Ky Komision që funksionon pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, ka në përbërjen e tij nga një përfaqësues nga KLGJ-ja, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, si dhe Kryetari i Gjykatës pranë së cilës ushtron detyrën gjyqtari, për të cilin kërkohet mbrojtje.

✚ **Vendimi nr. 674, datë 08.11.2023 "Për një ndryshim në udhëzimin nr. 38, datë 28.02.2019 "Për pagesat e gjyqtarëve në ditët e pushimit javor dhe festave zyrtare"**. Bazuar në riorganizimin e sistemit gjyqësor, të gjykatave të apelit dhe të shkallës së parë, u konstatua dhe u vlerësua ekzistenca e një situate të ndryshme juridike dhe faktike, e cila nxori në pah nevojën për të ndërhyrë dhe ndryshuar Udhëzimin nr. 38, datë 28.02.2019, "Për pagesat e gjyqtarëve në ditët e pushimit javor dhe festat zyrtare", ndryshim ky i cili lidhet me trajtimin financiar të gjyqtarëve, të cilët janë në listën e gatishmërisë gjatë ditëve të pushimit javor apo të festave zyrtare, por nuk zhvillojnë dhe gjykojnë çështje urgjente. Pasi u vlerësuan faktet dhe rrethanat përkatëse, Komisioni propozoi që gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë dhe/ose gjyqtari i gjykatës së apelit të kompensohet financiarisht, nëse është në listën e gatishmërisë ose gjykon çështje urgjente, për të cilat dispozitat procedurale parashikojnë se duhet të vendoset brenda 24-72 orëve nga regjistrimi i çështjes në gjykatë.

✚ **Vendimi nr. 716, datë 06.12.2023 "Për miratimin e Udhëzuesit Standard të Marrëdhënieve të Gjykatave me Publikun dhe Median"**. Në vazhdim të përpjekjeve të Këshillit për të garantuar transparencë dhe komunikim sa më cilësor me publikun dhe median, është hartuar dhe miratuar Udhëzuesi standard i marrëdhënies së gjykatave me publikun dhe median. Ky udhëzues ka për objekt përcaktimin e rregullave dhe procedurave të informimit dhe komunikimit me publikun dhe median, me ose pa interesimin e tyre të drejtpërdrejtë, me qëllim përcjelljen e informacionit mbi veprimtarinë e gjykatës në mënyrë të drejtë, uniforme, të barabartë, të shpejtë dhe efikase. Miratimi i këtyre rregullave krahas standardizimit të marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median, synon rritjen e transparencës, besimit të publikut dhe të kuptueshmërisë nga publiku dhe media të veprimtarisë gjyqësore.

- ✚ **Vendimi nr. 682, datë 14.11.2023, “Për miratimin e listës së gjyqtarëve kandidatë për anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për vitin 2024”.** Sikurse çdo vit KPSAB-ja është angazhuar me verifikimin e kriterëve që duhet të plotësojnë kandidatët për t’u përzgjedhur si anëtarë të KED-së. Pas verifikimeve të bëra, në varësi edhe të informacioneve të përcjella nga institucione të tjera përgjegjëse, KPSAB-ja i ka propozuar Këshillit listën e gjyqtarëve, kandidatë, që plotësojnë kushtet për t’u zgjedhur si anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Në kushtet kur në fund të vitit 2023, u krye ripërtëritja e pjeshme e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Komisioni miratoi disa vendimmarrje për mbarimin e mandatit të disa prej anëtarëve të tij, vendimmarrje këto që u pasuan me ndryshimin e përbërjes edhe të Komisioneve të Përhershme, të listuara si vijon:

- ✚ **Vendimi nr. 736, datë 12.12.2023 “Për deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtares së Këshillit të Lartë Gjyqësor znj. {...}”.**
- ✚ **Vendimi nr. 737, datë 12.12.2023 “Për deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtares së Këshillit të Lartë Gjyqësor znj. {...}”.**
- ✚ **Vendimi nr. 738, datë 12.12.2023 “Për deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor z. Dritan Hallunaj”.**
- ✚ **Vendimi nr. 742, datë 26.12.2023 “Për një ndryshim në vendimin nr.13, datë 18.01.2019 të KLGJ “Mbi ngritjen dhe përbërjen e Komisioneve të Përhershme” i ndryshuar,**

PAKETA E AKTEVE TË RISTRUKTURIMIT NË KUADËR TË ZBATIMIT TË HARTËS SË RE GJYQËSORE

Një nga çështjet më të rëndësishme që Këshilli ka konkluduar për vitin 2023 është miratimi dhe zbatimi i Hartës së Re Gjyqësore. Qëllimi i këtij projekti madhor ishte optimizimi i burimeve njerëzore, balancimi i ngarkesës së gjyqtarëve si dhe rritje e efikasitetit të sistemit gjyqësor. Ky proces u orientua jo vetëm nga detyrimet ligjore që buronin kryesisht nga Ligji Nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, por mbi të gjitha nga një bashkëpunim gjithëpërfshirës me institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë dhe grupet e interesit.

Sikurse dëshmohet, veprimtaria e KPSAB-së gjatë vitit 2023 është përqendruar në hartimin dhe miratimin në seancë plenare të një pakete aktesh administrative dhe individuale të cilat përkojnë me fazat e zbatimit të vetë Hartës së Re Gjyqësore.

Faza e dytë⁷ - Riorganizimi i gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, në kudër të së cilës janë vendimmarrjet e listuara si vijon:

- **Vendimin nr. 129, datë 28.03.2023** “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër”.
- **Vendimin nr. 130, datë 28.03.2023** “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”.
- **Vendimin nr. 131, datë 28.03.2023** “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier”.
- **Vendimin nr. 132, datë 28.03.2023** “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë”.
- **Vendimin nr. 133, datë 28.03.2023** “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë”.
- **Vendimin nr. 134, datë 28.03.2023** “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë”.
- **Vendimin nr. 135, datë 28.03.2023** “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës”.
- **Vendimin nr. 136, datë 28.03.2023** “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër”.
- **Vendimin nr. 137, datë 28.03.2023** “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”.
- **Vendimin nr. 138, datë 28.03.2023** “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat”.
- **Vendimin nr. 139, datë 28.03.2023** “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan”.
- **Vendimin nr. 140, datë 28.03.2023** “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë”.
- **Vendimin nr. 141, datë 28.03.2023** “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë”.

Në këtë grup spikasin aktet e mëposhtme:

- **Vendimi nr. 146, datë 29.03.2023** “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm”, i cili parashikon parimet mbi të cilat do të bëhet riorganizimi dhe funksionimi i 13 gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm. Përcaktimi i numrit të gjyqtarëve është mekanizmi kryesor i ekuilibrit të ngarkesës së gjykatës dhe vetë gjyqtarëve, duke siguruar një rishpërndarje të drejtë të ngarkesës së gjyqtarëve në gjykatat e rretheve gjyqësore.
- **Vendimi nr. 147, datë 29.03.2023** “Për përcaktimin e kategorive të gjykatave”. i cili vjen në respektim të pikës 5, të nenit 64, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e

⁷ Kujtojmë këtu që faza e parë e zbatimit të Hartës lidhej me ri-organizimin e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, e cila filloi funksionimin më 1 shkurt 2023. Për rrjedhojë, puna përgatitore për të mundësuar funksionimin e kësaj gjykate është raportuar në Raportin e vitit të shkuar.

pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku ndër të tjera përcaktohet se: “Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendim përcakton tri kategoritë e kancelarëve, në përputhje me ngarkesën dhe nivelin e çdo gjykate”. Nisur nga ky fakt, për efekt të përcaktimit të pagave të kancelarëve si dhe për rritjen e tyre në karrierë lind nevoja e kategorizimit të gjykatave. Bazuar në analizimin dhe gërshetimin e disa elementëve⁸ Komisioni i ka propozuar Këshillit të Lartë Gjyqësor klasifikimin e gjykatave në tri kategori (kategoria e parë, e dytë dhe e tretë).

Riorganizimi pashmangshmërisht shtroi nevojën **për përcaktimin e standardeve të administrimit të brendshëm gjyqësor** si dhe miradministrim e burimeve njerëzore. Nën këtë fokus, Komisioni, pasi një analize të hollësishme në bashkëpunim edhe me strukturat përkatëse të administratës, ka hartuar vendimmarrjet e listuara si më poshtë:

- **Vendimin nr. 148, datë 29.03.2023** “Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, kategoria e parë, me zyrë shërbimi”.
- **Vendimin nr. 149, datë 29.03.2023** “Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, kategoria e dytë dhe e tretë, pa zyra shërbimi”.
- **Vendimin nr. 150, datë 29.03.2023** “Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, kategoria e dytë dhe e tretë, me zyra shërbimi”.
- **Vendimin nr. 151, datë 29.03.2023** “Për rishpërndarjen e numrit të pozicioneve të punës në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm”.

Me qëllim funksionalitetin e gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm tashmë të riorganizuar, lindi nevoja e miratimit të disa akteve për krijimin dhe funksionimin **e Komisioneve të Ristrukturimit të gjykatave respektive**, komisione këto që patën rëndësi të veçantë në kuadër të sistemimit të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë gjyqësorë me qëllim për të siguruar ofrimin e shërbimeve në kohë dhe me cilësi.

- **Vendimin nr. 162, datë 06.04.2023** “Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat”.
- **Vendimin nr. 163, datë 06.04.2023** “Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë”.
- **Vendimin nr. 164, datë 06.04.2023** “Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë”.

⁸ Të tillë si: (i) nivelit të gjykatës; (ii) mesatares së çështjeve të reja të regjistruara për periudhën 2019-2022; (iii) numrin e gjyqtarëve sipas drafitit të grupit të punës për hartën e re gjyqësore,

- **Vendimin nr. 165, datë 06.04.2023** “Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet”.
- **Vendimin nr. 166, datë 06.04.2023** “Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin”.
- **Vendimin nr. 167, datë 06.04.2023** “Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec”.
- **Vendimin nr. 168, datë 06.04.2023** “Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë”.
- **Vendimin nr. 169, datë 06.04.2023** “Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë”.
- **Vendimin nr. 170, datë 06.04.2023** “Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë”.
- **Vendimin nr. 171, datë 07.04.2023** “Për një ndryshim në vendimin nr. 167, datë 06.04.2023 “Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec”.
- **Vendimin nr. 285, datë 29.05.2023** “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 557, datë 29.12.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisioneve të ristrukturimit”.

Faza e tretë e zbatimit të Hartës së Re Gjyqësore, përkoi me riorganizimin e gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të posaçëm (administrativ) në 2 të tilla. Në frymën e këtij riorganizimi, janë propozuar vendimmarrjet e mëposhtme:

- **Vendimin nr. 271, datë 25.05.2023** “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë të riorganizuar”, me seli në qytetin e Tiranës dhe kompetencë tokësore, që përfshin rrethet gjyqësore Tiranë, Durrës, Shkodër, Kukës, Dibër, Elbasan, Lezhë dhe Korçë.
- **Vendimin nr. 272, datë 25.05.2023** “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë”, e cila përcaktoi selinë në qytetin e Lushnjës dhe kompetencë tokësore, që përfshin rrethet gjyqësore Berat, Fier, Gjirokastrë, Sarandë dhe Vlorë.

Gjithashtu, përmes akteve të posaçme⁹, KPSAB-ja ka miratuar që gjykatat pritëse brenda muajit korrik 2023, duhet të përmbushin të gjitha detyrimet dhe përgjegjësitë që rridhnin nga mbyllja e aktivitetit ekonomiko-financiar të gjykatave administrative të shkallës së parë Durrës, Korçë dhe Shkodër.

Fillimi i funksionimit të Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë Tiranë e Lushnjë diktoi nevojën për organizimin dhe vendosjen e rregullave për administrimin e brendshëm gjyqësor, duke synuar vijimin e ofrimit të shërbimeve gjyqësore, administrative dhe mbështetëse. Për të mundësuar sa më sipër, Komisioni ka hartuar dhe miratuar vendimmarrjet e mëposhtme:

⁹ **Vendimin nr. 328, datë 14.06.2023** “Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr. 271, datë 25.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë të Riorganizuar”.

- **Vendimin nr. 286, datë 29.05.2023** “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve në gjykatat administrative të shkallës së parë”, ku u miratua se struktura organizative për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë është me 9 gjyqtarë, ndërsa Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë është me 27 gjyqtarë.
- **Vendimin nr. 298, datë 30.05.2023** “Mbi miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”. Miratimi i strukturës organizative dhe organigramës, synonte përcaktimin e strukturave funksionale, pozicioneve dhe numrit të tyre, më qëllim rregullimin e funksionalitetit të këtyre gjykatave.

Me qëllim rregullimin e funksionalitetit të dy gjykatave administrative të shkallës së parë, Komisioni miratoi ndarjen dhe evidentimin e pozicioneve të punës të atyre punonjësve që kanë status të nëpunësit civil dhe atyre që trajtohen me kod pune. Konkretisht:

- **Vendimi nr. 230 datë 30.05.2023** “Për caktimin e numrit të pozicioneve të punës në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”.
- **Vendimi nr. 231 datë 30.05.2023** “Për caktimin e numrit të pozicioneve të punës në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë”.

Procesi i verifikimit dhe më pas i sistemimit të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë në 2 gjykatat administrative u realizua nga Komisionet e Ristrukturimit, miratuar me vendimet:

- **Vendimi nr. 303 datë 05.06.2023** “Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të gjykatave administrative të shkallës së parë Durrës, Korçë dhe Shkodër”.
- **Vendimi nr. 304 datë 05.06.2023** “Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të gjykatave administrative të shkallës së parë Gjirokastrë dhe Vlorë”.
- **Vendimi nr. 299, datë 30.05.2023** “Mbi miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë”.

Në mënyrë të pashmangshme, riorganizimi i gjykatave passolli edhe nevojën urgjente për miradministrim të sistemit gjyqësor nga pikëpamja logjistike, e cila reflektohet nga aktet e listuara si më poshtë:

- **Vendimin nr. 108, datë 13.03.2023** “Për rishpërndarjen e mjeteve të transportit (autovetura dhe motoçikletë), në disa gjykata”, vendimmarrje e cila vjen pas analizës të gjendjes së përgjithshme teknike të këtyre mjeteve, dhe kërkesave të ardhura nga gjykatat (gjatë hartimit të kërkesave të buxhetit afatmesëm 2023-2025, për sistemin gjyqësor).

- **Vendimin nr. 109, datë 13.03.2023** “Për miratimin për nxjerrjen nga përdorimi të disa aktiveve, në disa gjykata”. Për shkak të ristrukturimit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor janë depozituar kërkesa nga pesë ish-gjykatat e apelit dhe disa gjykata të rretheve gjyqësore e administrative, për nxjerrjen nga përdorimi të disa aktiveve pjesë e inventarit të tyre si: pajisje elektronike, mobilie zyre, pajisje sigurie, pajisje të tjera dhe automjete. Struktura përgjegjëse për administrimin dhe menaxhimin e aktiveve në KLGJ, në përfundim të administrimit, vlerësimit dhe verifikimit të të gjithë dokumentacionit të dërguar mbi procedurën e ndjekur nga gjykatat, konstatoi se, janë zbatuar të gjitha kërkesat dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, në lidhje me inventarizimin periodik, vlerësimin e aktiveve dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve në sektorin publik. Në këto kushte, është vendosur miratimi i nxjerrjes nga përdorimi të disa aktiveve në ish-gjykatat e apelit përkatëse si dhe në disa gjykata të rretheve gjyqësore.
- **Vendimin nr. 142, datë 28.03.2023** “Mbi miratimin për nxjerrjen nga përdorimi dhe transferimin pa pagesë të gjeneratorit dhe UPS qendrore”.
- **Vendimin nr. 353, datë 06.07.2023** “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e mjeteve të transportit (autovetura dhe motoçikleta), në disa gjykata”.
- **Vendimin nr. 354, datë 06.07.2023** “Mbi miratimin për nxjerrjen nga përdorimi të disa aktiveve, në disa gjykata”.
- **Vendimin nr. 355, datë 06.07.2023** “Mbi miratimin për nxjerrjen nga përdorimi dhe transferimin pa pagesë të serverit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër”.
- **Vendimin nr. 361, datë 13.07.2023** “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e mjeteve të transportit (autovetura dhe motoçikletë), në gjykatat administrative”.
- **Vendimin nr. 446, datë 24.07.2023** “Mbi shpërndarjen e aktiveve (pajisjeve elektronike dhe aseteve të ndryshme software), në gjykatat e të tre niveleve”.
- **Vendimin nr. 476, datë 13.09.2023** “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e disa automjeteve (autovetura), në sistemin gjyqësor”.
- **Vendimin nr. 641, datë 26.10.2023** “Mbi miratimin për nxjerrjen nga përdorimi të disa aktiveve, në dy gjykata”.
- **Vendimin nr. 709, datë 04.12.2023** “Mbi transferimin e një automjeti (autoveturë), në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë”.
- **Vendimin nr. 724, datë 07.12.2023** “Për rindarjen me short të çështjeve gjyqësore”, i cili gjen një elaborim në kapitullin: Përmirësimet në infrastrukturën teknologjike në funksion të rritjes së transparencës, efijencës dhe aksesit në sistemin gjyqësor.

Komisioni gjatë veprimtarisë së tij ka vijuar me zbatimin e reformës së administratës gjyqësore duke vlerësuar rolin dhe rëndësinë që ka personeli mbështetës në rritjen e efikasitetit të sistemit gjyqësor. Sikurse vihet re dhe nga vendimmarrjet e listuara më poshtë, fokusi i veprimtarisë së Komisionit gjatë vitit 2023 është zhvendosur tek gjykatat e apelit. 6 akte nga 14¹⁰ të hartuara nga KPSAB-ja kanë lidhje me kualifikimin dhe vijimin e procedurës së emërimit në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë gjykatave të apelit (juridiksionit të përgjithshëm dhe administrativ). Ndërkohë 1 akt lidhet me të njëjtat procedura por për pozicionin e këshilltarit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë. Këto vendimmarrje me karakter individual vijnë në kuadrin e ndikimit që ka pasur procesi i rivlerësimit kalimtar në këto gjykata si dhe përpjekjeve për të menaxhuar situatën duke ofruar një mbështetje me burime njerëzore ndihmëse.

- ✚ **Vendimin nr. 222, datë 08.05.2023** “Për kualifikimin e kandidates fituese për në programin e formimit fillestar të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2021 – 2022, profili këshilltar ligjor, znj. R.E”.
- **Vendimin nr. 705, datë 30.11.2023** “Për kualifikimin për emërimin dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. R.E për pozicionin e këshilltarit ligjor në njësinë e shërbimit ligjor pranë Gjykatës së Lartë”.

- ✚ **Vendimin nr. 259, datë 24.05.2023** “Për shfuqizimin e vendimit të pezullimit me nr. 642, datë 23.12.2020, “Për shqyrtimin e kërkesës për pasje/njohje të statusit të këshilltarit/ndihmësit ligjor jomagjistrat pranë Gjykatës së Lartë të z. A.B”.

- ✚ **Vendimin nr. 260, datë 24.05.2023** “Për përfundimin pa vendim përfundimtar të shqyrtimit të kërkesës për pasje/njohje të statusit të këshilltarit/ndihmësit ligjor jomagjistrat pranë Gjykatës së Lartë të z. A.B”.

- ✚ **Vendimin nr. 80, datë 16.02.2023** “Për transferimin e ndihmësit ligjor z. E.A, në njësinë e shërbimit ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”.

- ✚ **Vendimin nr. 284, datë 25.05.2023** “Për kualifikimin e kandidates fituese për në programin e formimit fillestar të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2022 – 2023, profili ndihmës ligjor, znj. I.T”.
- **Vendimin nr. 704, datë 30.11.2023** “Për kualifikimin për emërimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. I.T për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit”

¹⁰ Dy akte, përkatësisht vendimi nr. 703, datë 30.11.2023 dhe vendimi nr. 706, datë 04.12.2023, i referohen deklaratit të përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatit fitues për në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, viti akademik 2023 – 2024, profili ndihmës ligjor (z. O.C dhe znj. Sh.R)

- **Vendimin nr. 732, datë 07.12.2023** “Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. I.T për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësinë e shërbimit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit”
- ✚ **Vendimin nr. 497, datë 28.09.2023** “Për kualifikimin për emërimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. J.B për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit”.
- **Vendimin nr. 508, datë 05.10.2023** “Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. J.B për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësinë e shërbimit ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”.
- ✚ **Vendimin nr. 498, datë 28.09.2023** “Për kualifikimin për emërimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. K.G për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit”.
- **Vendimin nr. 509, datë 05.10.2023** “Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. K.G për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësinë e shërbimit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”.

Krahas pranimit në shërbimin civil gjyqësor të 3 ndihmësve ligjorë në gjykatat e apelit në vend (juridiksionit të përgjithshëm dhe administrativ) dhe 1 këshilltari në Gjykatën e Lartë, Komisioni, në monitorim të vazhduar të situatës, i ka propozuar Këshillit hapjen në mënyrë të përsëritur të vakancave, sidomos në gjykatat e apelit, përmes akteve të mëposhtme:

- **Vendimin nr. 504, datë 28.09.2023** “Për shpalljen e vendeve vakante në pozicionin e ndihmësit ligjor, në njësinë e shërbimit ligjor në gjykatat e apelit”.
- **Vendimin nr. 718, datë 06.12.2023** “Për shpalljen e vendeve vakante në pozicionin e ndihmësit ligjor, në njësinë e shërbimit ligjor në gjykatat e apelit”

Pjesë integrale e kompetencave administrativo–menaxheriale janë edhe vendimmarrjet me fokus burimet njerëzore, e sidomos në kushtet e riorganizimit për shkak të Hartës së Re Gjyqësore. Kështu, me qëllim sigurimin e trupës gjyqësore por dhe personelit gjyqësor ndihmës dhe mbështetës, dhe në zbatim të dispozitave ligjore, KPSAB-ja ka përfunduar **zhvillimin e procedurave për verifikimin e 7 kancelarëve në detyrë**. Me anë të vendimeve në seancë plenare, KLGJ-ja, me propozim të Komisionit, ka vendosur: kualifikimin dhe lejimin për të marrë pjesë në provimin e vlerësimit profesional për 4 kancelarë në detyrë; skualifikimin dhe ndërprerjen e marrëdhënies së punës për 1 kancelar; ndërprerjen e marrëdhënies të punës për 1 kancelar; si dhe përfundimin e shqyrtimit pa vendimmarrje për 1 kancelar.

- **Vendimi nr. 261, datë 24.05.2023** “Për deklarimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të pozicionit, pasurisë dhe figurës për z. S.M, ish-kancelar në detyrë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat”.

- **Vendimi nr. 461, datë 25.07.2023** “Për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor të kancelares së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për shkak të dorëheqjes”.
- **Vendimi nr. 675, datë 08.11.2023** “Për kualifikimin dhe lejimin për të marrë pjesë në provimin e vlerësimit profesional të kancelarit në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, z.D.Xh”.
- **Vendimi nr. 691, datë 15.11.2023** “Për skualifikimin dhe ndërprerjen e marrëdhënies së punës së kancelares në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, znj. V.S.
- **Vendimi nr. 692, datë 15.11.2023** “Për kualifikimin dhe lejimin për të marrë pjesë në provimin e vlerësimit profesional të kancelares në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, znj. A.D”.
- **Vendimi nr. 715, datë 06.12.2023** “Për kualifikimin dhe lejimin për të marrë pjesë në provimin e vlerësimit profesional të kancelares në detyrë, znj. E.H”.
- **Vendimi nr. 714, datë 06.12.2023** “Për kualifikimin dhe lejimin për të marrë pjesë në provimin e vlerësimit profesional të kancelarit në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan z. L.S dhe caktimin e masës disiplinore ndaj tij”.

Ndër vendimmarrjet e tjera të KPSAB-së në funksion të administrimit të sistemit gjyqësor nga pikëpamja administrative dhe menaxheriale, spikasin vendimmarrjet e mëposhtme:

- ✚ **Vendimi nr. 34, datë 19.01.2023** “Për përbërjen e Komisionit të Përkohshëm për Shqyrtimin e Ankimeve kundër Vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për Arkivimin e Ankimit ose Pushimin e Hetimit ndaj një Gjyqtari, për vitin 2023”. Kjo vendimmarrje vjen në respektim të vendimit nr. 170, datë 28.05.2020, i cili përcakton, ndër të tjera se, KPSHA-ja do të ripërtëritet brenda muajit janar të çdo viti. Për rrjedhojë, Komisioni i ka propozuar Këshillit të Lartë Gjyqësor, kompozimin e këtij Komisionit të Përkohshëm i cili do të shqyrtojë të gjitha ankesat kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për Arkivimin e Ankimit ose Pushimin e Hetimit ndaj një gjyqtari (KPSHA), për vitin kalendarik 2023. Bazuar në nenin 6 të Rregullores që normon veprimtarinë e këtij Komisioni përcaktohet se Komisioni i Përkohshëm ka në përbërje, tre anëtarë, nga të cilët dy anëtarë jogjyqtarë dhe një anëtar gjyqtar, si dhe dy anëtarë zëvendësues konkretisht, një anëtar gjyqtar zëvendësues dhe një anëtar jogjyqtar zëvendësues.
- ✚ **Vendimi nr. 662, datë 02.11.2023** “Për një ndryshim në vendimin nr. 280, datë 10.12.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për caktimin e gjyqtarëve për mediat”, i ndryshuar. Përmes këtij vendimi, Komisioni i ka propozuar Këshillit të Lartë Gjyqësor zëvendësimin e disa prej gjyqtarëve aktual për median në gjykatat respektive me gjyqtarë të tjerë. Ky ndryshim vjen si rezultat i ristrukturimit dhe

administrimit të sistemit gjyqësor, ndryshim i cili ka prekur kryesisht gjykatat e rretheve gjyqësore Elbasan, Gjirokastër, Sarandë dhe Lezhë. Ajo që do duhet të evidentohet është fakti që Komisioni ka dyfishuar numrin e gjyqtarëve të medias. Aktualisht, për vitin 2023 janë caktuar 17 gjyqtarë të medias që mbulojnë gjykatat e shkallës së parë dhe apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe posaçëm, nga 8 të tillë që ishin në 2022. Ky dyfishim i numrit të gjyqtarëve të medias dëshmon për angazhimin konkret të Komisionit dhe Këshillit për rritjen e aksesit dhe transparencës të publikut mbi sistemin gjyqësor.

- ✚ **Vendimi nr. 673, datë 08.11.2023 “Për detajimin e numrit të punonjësve për vitin 2023”.** Në përfundim të zbatimit të Hartës së re Gjyqësore, u realizua një analizë e kërkesave të gjykatave për punonjës në kuadër edhe të buxhetit për vitin 2023, bazuar mbi numrin efektiv të punonjësve, numrit të çështjeve gjyqësore, ngarkesës së gjykatave, raportit të gjyqtarëve me stafin administrativ, etj. Komisioni, i ka propozuar Këshillit detajimin e numrit të punonjësve duke vlerësuar kërkesat e paraqitura si nga vetë Këshilli i Lartë Gjyqësor (për 10 punonjës shtesë), ashtu edhe nga gjykatat e të gjitha niveleve, për shtimin e strukturës organizative aktuale (20 punonjës shtesë për gjykatat e të gjitha niveleve).
- ✚ **Vendimi nr. 695, datë 21.11.2023 “Për një ndryshim në vendimin nr. 12, datë 18.01.2019 “Për miratimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i ndryshuar.** Përmes këtij vendimi, KPSBA-JA i propozoi KLGJ-së detajimin e numrit të punonjësve për vitin 2023, ku Këshilli të Lartë Gjyqësor i janë akorduar 10 pozicione pune shtesë. Për rrjedhojë, struktura organizative e KLGJ-së ndryshon nga 128 punonjës për vitin 2022, në 138 për vitin 2023.
- ✚ **Vendimi nr. 67, datë 09.02.2023 “Për ngritjen dhe përbërjen e Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kandidatëve për në Provimin e Pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për Kancelar dhe/ose për Ndihmës ligjor për vitin akademik 2023-2024”.** Miratimi i këtij vendimi i hapi rrugën procesit të aplikimit, dhe më tej, të regjistrimit për konkurrim në Shkollën e Magjistraturës, të kandidatëve për kancelarë, këshilltarë dhe ndihmës ligjorë. Sipas këtij vendimi Komisioni i Përkohshëm përbëhet nga tre anëtarë, 2 anëtarë gjyqtarë dhe 1 anëtar jogjyqtar, të cilët zgjidhen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me short. Kryetari i Komisionit zgjidhet nga anëtarët e tij me propozim të Kryetarit të Këshillit.
- ✚ **Vendimi nr. 473, datë 07.09.2023 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve fitues në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për ndihmës ligjorë, viti akademik 2023-2024”.**
- ✚ **Vendimi nr. 302, datë 05.06.2023 “Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e kushteve dhe dokumentacionit që duhet të plotësojë magjistrati**

(gjqtar) për të përfituar kredi për banim, si dhe miratimin e listës së magistratëve (gjqtarë) përfitues nga skema e subvencionimit të interesave të kredisë”.

Në funksion të mirëfunksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe buxhetor, KPSAB-ja ka ndërmarrë disa vendimmarrje, duke i propozuar seancës plenare për shqyrtim dhe miratim projekt-aktet e mëposhtme:

- ✚ **Udhëzimin nr. 78, datë 16.02.2023 “Për llogaritjen e pagës referuese bazë të magistratit (gjqtar)”**. Ky vendim vjen në respektim të Vendimit nr. 35, datë 22.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese. Në logjikën e vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese, Komisioni i propozon Këshillit, si më poshtë vijon;
 - Llogaritjen e “pagës referuese bazë” të magistratit (gjqtar), nga data 09 janar 2023 e në vazhdim, sipas VKM nr. 621/2022, e barabartë me vlerën e “pagës për funksion” të punonjësit të shërbimit civil Klasa e parë (I), Kategoria e dytë (I-b), niveli I-b.
 - «Paga referuese bazë» e magistratit (gjqtar), të llogaritet si shumatore e vlerës së «shtesës për pozicion» e përcaktuar në VKM 621/2022, në shumën 138,700 lekë me vlerën e «pagës së grupit» në shumën 14,000 lekë, në total në shumën 152,700 lekë (138,700 + 14,000).
 - Përllogaritjen e fondeve buxhetore shtesë për vitin 2023, për sistemin gjyqësor, për periudhën 09 janar 2023 deri 31 dhjetor 2023, duke mbajtur parasysh si “pagë referuese bazë” për funksionet gjyqësore, atë të përcaktuar në pikën 1 dhe 2 të këtij udhëzimi.

- ✚ **Vendimin nr. 661, datë 02.11.2023 “Për përllogaritjen e pagës referuese bazë të magistratit (gjqtar), për periudhën 1 janar 2019 deri më 08 janar 2023”**. Ky vendim i Komisionit gjen mbështetje në Vendimin nr. 35, datë 22.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese e cila e ka vlerësuar çështjen nën dritën e parimit të pavarësisë së pushtetit gjyqësor. Përmes këtij akti, KPSAB-ja shqyrtoi dhe miratoi “Pagën referuese bazë” të magistratit (gjqtar), si dhe përllogaritjen e “Pagës referuese bazë” të magistratit (gjqtar), duke përfshirë edhe efektet financiare që ka prodhuar vendimi nr. 351, datë 27.07.2022 i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

- ✚ **Vendimin nr. 79, datë 16.02.2023 “Për detajimin e fondit të veçantë për sistemin gjyqësor, për vitin 2023”**. Përmes këtij vendimi, Këshilli ka miratuar detajimin e fondit të veçantë, për sistemin gjyqësor, në shumën prej 4 500 000 lekë për tre programet buxhetore, i cili nuk është pjesë e fondeve të miratuara me ligjin e buxhetit vjetor. Përkatësisht:
 - për programin 01110, që i referohet buxhetit për Këshillin e Lartë Gjyqësor, në shumën 1 200 000 lekë,
 - programin 01140, që i referohet buxhetit për QTI-në në shumën 100 000 lekë
 - dhe programin 03310, që i referohet buxhetit për gjykatat, në shumën 3 200 000 lekë.

- ✚ **Vendimin nr. 198, datë 26.04.2023 “Mbi miratimin kërkesave buxhetore për programin buxhetor afatmesëm 2024-2026 (PBA 24-26), për sistemin gjyqësor, (faza e parë)”**. Bazuar në dokumentacionin e përgatitur nga struktura përkatëse, KPSAB – ja, i ka propozuar Këshillit miratimin e kërkesave për fonde buxhetore për sistemin gjyqësor, KLGJ, QTI për fazën e parë strategjike, për periudhën 2024–2026. Kërkesa këto që janë përgatitur duke pasur parasysh nevojat buxhetore në përputhje me vizionin, misionin, qëllimin, synimet dhe objektivat strategjike të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Me këtë vendimmarrje Këshilli miratoi kërkesat buxhetore, për fazën e parë strategjike, duke pasur parasysh si tavanet përgatitore të miratuara, ashtu edhe historikun e realizimit të shpenzimeve sipas programeve, gjatë vitit buxhetor 2022 dhe ato në buxhetin e miratuar për sistemin gjyqësor për vitin 2023.
- ✚ **Vendimin nr. 423, datë 11.05.2023 “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e fondeve buxhetore në programin 03310, për vitin buxhetor 2023.**
- ✚ **Vendimi 232, datë 11.05.2023 “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e fondeve buxhetore në programin 03310, për vitin buxhetor 2023”**. KPSAB-ja, pas analizimit të kërkesave buxhetore të disa gjykatave për fonde shtesë në shpenzime korrente, si dhe analizimit të situatës buxhetore në këto gjykata, vlerësoi se në programin 03310, “Buxheti Gjyqësor”, është e nevojshme rishpërndarja e fondeve buxhetore sipas nevojave të paraqitura nga gjykatat dhe analizave të bëra nga strukturat përkatëse për administrimin e buxhetit. Në këto kushte, KPSAB-ja, i propozoi Këshillit që të gjitha fondet që rezultojnë të papërdorura nga gjykatat, që janë mbyllur si efekt i riorganizimit të hartës gjyqësore, në shpenzime korrente (600, 601, 602, 606), si dhe shpenzime kapitale (231), duhet të transferohen në programin 03310, “Buxheti Gjyqësor”, propozim ky që u shqyrtua dhe miratua nga Këshilli në funksion të plotësimit të nevojave të gjykatave për shpenzime personeli dhe shpenzime operative.
- ✚ **Vendimin nr. 362, datë 13.07.2023 “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e fondeve buxhetore në programin 03310, për vitin buxhetor 2023.** Duke qenë se përfundimi i ristrukturimit të gjykatave në tre nivelet, u shoqërua me ndryshime (shtesa dhe pakësime) si në strukturat organizative ashtu edhe në organikat në fakt (gjyqtarë dhe administratë gjyqësore), doli e domosdoshme rishpërndarja (transferimi) e fondeve buxhetore në shpenzime korrente, për të bërë të mundur përballimin e efektit financiar që rrjedh nga ky riorganizim, në të gjitha gjykatat e të tre niveleve. Plotësimi i nevojave u propozua të realizohet nga fondi i mbajtur në administrim në KLGJ, programi 03310, “Buxheti Gjyqësor”.
- ✚ **Vendimin nr. 447, datë 24.07.2023 “Mbi ndryshimin e destinacionit dhe transferimin e fondeve në programin 03310, shpenzime kapitale, për vitin buxhetor 2023”**. Propozimi i këtij akti, në seancë plenare ka ardhur pas shqyrtimit dhe miratimit në Komision të dokumentit të ndryshimit të destinacionit dhe transferimit të fondeve në programin 03310, shpenzime kapitale, për vitin buxhetor 2023. Kjo për faktin se Ministria e Financave dhe Ekonomisë, fondet buxhetore në shpenzime kapitale, për vitin 2023, i ka miratuar me vonesë dhe një pjesë të këtyre

fondeve që kishin të bënin me Programet Software i ka çelur të ngrira. Vonesa në çlirimin e fondeve buxhetore të miratuara me ligj, ka vendosur në vështirësi të madhe realizimin e projekteve të reja. Me qëllimin përdorimin me efektivitet dhe efikasitet të këtyre fondeve është vlerësuar ndryshimi i destinacionit të fondeve për realizimin e blerjeve të pajisjeve elektronike për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe për gjykatat referuar kërkesave dhe nevojave të pasqyruara në kërkesat buxhetore PBA 24-26.

- ✚ **Vendimin nr. 472, datë 24.08.2023 “Mbi miratimin kërkesave buxhetore për programin buxhetor afatmesëm 2024-2026 (PBA 24-26), për sistemin gjyqësor, (faza e dytë)”.** Në hartimin e këtij akti, KPSAB-ja ka argumentuar se kërkesat buxhetore, janë përgatitur duke pasur parasysh nevojat buxhetore në përputhje me vizionin, misionin, qëllimin, synimet dhe objektivat strategjike të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Më konkretisht, kërkesat buxhetore janë përgatitur për të tre programet buxhetore ku përfshihen programet e “Planifikim, Menaxhim dhe Administrimit”, “Buxheti Gjyqësor” dhe “Mbështetja për Teknologjinë e Sistemit të Drejtësisë”.

Një grup vendimmarrjesh të listuara si më poshtë, vijnë si rezultat i ndryshimeve në kategorizimet e pagës, miratuar përmes VKM nr. 325, datë 31.05.2023. “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesa të tjera mbi pagë të Zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, Prefektit, Nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të Administratës Publike.

- ✚ **Vendimin nr. 443, datë 24.07.2023 “Për një ndryshim në vendimin nr. 157, datë 20.04.2022 “Për miratimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i ndryshuar”.**
- ✚ **Vendimin nr. 444, datë 24.07.2023 “Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave për administratën gjyqësore”.**
- ✚ **Vendimin nr. 475, datë 13.09.2023 “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e fondeve buxhetore në programin 03310, shpenzime korrente, për vitin buxhetor 2023”.**
- ✚ **Vendimin nr. 495, datë 21.09.2023 “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e fondeve në grupin buxhetor Këshilli i Lartë Gjyqësor, programin 03310, shpenzime kapitale, për vitin buxhetor 2023”.** Nga analiza e bëra nga struktura përgjegjëse e investimeve pranë KLGJ-së dhe nga komunikimet me gjykatat rezultoi tepërca fondesh pas përfundimit të procedurave të prokurimeve si dhe një pjesë e fondeve të planifikuara në disa projekte ishin të pamundura të realizoheshin. Për këtë arsye, KPSAB-ja ka kërkuar rishpërndarjen (transferimin) e fondeve buxhetore në shpenzime kapitale në nivel njësie shpenzuese dhe në nivel projekti.
- ✚ **Vendimin nr. 640, datë 26.10.2023 “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e fondeve buxhetore në programin 03310, në shpenzime korrente, për vitin 2023”.** të Buxhetit. Vendimmarrje e cila vjen si pasojë e nevojës për përbalimin e efektit

financiar që rezulton nga emërimet e gjyqtarëve të emëruar më datë 12.10.2023, të diplomuar në përfundim të programit trevjeçar të formimit fillestar 2020-2023”, si dhe nga ekzekutimi i vendimeve gjyqësore.

✚ **Vendimin nr. 719, datë 06.12.2023 “Mbi trajtimin financiar të magistratëve, profili gjyqtarë, të diplomuar në vitin akademik 2022 – 2023”.** Të diplomuarit nga Shkolla e Magjistraturës në vitin akademik 2022-2023 kanë depozituar 7 kërkesë padi, me objekt: “Detyrimin e palës së paditur Këshilli i Lartë Gjyqësor të trajtojë financiarisht secilin prej paditësve të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës në vitin akademik 2022-2023,”. Duke marrë në konsideratë se: praktika gjyqësore e deritanishme e gjykatës në çdo rast ka vendosur detyrimin e KLGJ-së që të trajtojë financiarisht të diplomuarit nga Shkolla e Magjistraturës, për efekt të ekonomisë gjyqësore, me qëllim shmangien e proceseve gjyqësore të ngjashme të cilat sjellin shpenzimet të konsiderueshme të buxhetit të KLGJ-së si dhe faktin që KLGJ, për vitin buxhetor 2023, në miratimin e detajimit të fondeve buxhetore kishte parashikuar edhe trajtimin financiar të magistratëve të rinj, është miratuar rishpërndarja e fondeve në shpenzime personeli për këtë qëllim.

✚ **Vendimin nr. 741, datë 26.12.2023 “Për detajimin e fondeve buxhetore shtesë në shpenzime korrente, në buxhetin e vitit 2023, për sistemin gjyqësor”.** Me VKM nr. 755, datë 20.12.2023 “Për një shtesë në buxhetin e miratuar për vitin 2023 për disa institucione të pavarura, të krijuara me ligj”, janë miratuar fonde shtesë në shpenzime korrente në grupin buxhetor Këshilli i Lartë Gjyqësor, për vitin buxhetor 2023, në shumën prej 350,000 mijë lekë. Këto fonde buxhetore do të shërbenin për të përballuar pjesërisht efektin financiar si rezultat i ndryshimit të pagës referuese të magistratit (gjyqtarit) në përputhje me Vendimin e Gjykatës Kushtetuese për periudhën 01 janar 2019 – 08 janar 2023, për të gjithë magistratët dhe jomagjistratët të cilët preken nga ky vendim.

✚ **Vendimin nr. 743, datë 28.12.2023 “Për detajimin e buxhetit vjetor, viti 2024, për sistemin gjyqësor”,** në të cilën është bërë detajimi i fondeve buxhetore (shpenzime personeli, shpenzime korrente dhe shpenzime kapitale) për vitin buxhetor të vitit 2024, për 3 programet që përfshihen në grupin buxhetor “Këshilli i Lartë Gjyqësor”. Detajimi i buxhetit vjetor është bërë në nivel programi”, në nivel artikulli si dhe në nivel njësie shpenzuese, për vitin 2024 si dhe janë detajuar tavanet buxhetore për vitin 2025 dhe 2026.

6. PËRMIRËSIMET NË INFRASTRUKTURËN TEKNOLOGJIKE NË FUNKSION TË RITJES SË TRANSPARENCËS, EFIÇENCËS DHE AKSESIT NË SISTEMIN GJYQËSOR

Pas zhvillimit dhe zbatimit të ndryshimeve strategjike në sistemet e menaxhimit të çështjeve në gjykata (case-management informatic system) të kryera një vit më parë, gjatë vitit 2023 ka

vazhduar monitorimi i zbatimit të tyre në praktikë dhe është dhënë mbështetja e nevojshme nëpërmjet sistemit të ngritur “ticketing desk”. Në këtë aspekt është ofruar mbështetje teknike për të gjithë gjykatat lidhur me 1027 kërkesa të administruara për suport.

Disa nga ndryshimet më të rëndësishme të kryera gjatë këtij viti raportues janë:

▫ **Zhvillimi mbi shpërndarjen e çështjeve me short elektronik sipas vendimit nr.**

554, datë 29.12.2023 "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore".

KLGG-ja në përpjekjen për të rritur sigurinë e informacionit, në veçanti në procesin e shortimit të çështjeve ka kryer zhvillime teknike që mundësojnë:

1. Zhvillimin e shortit në njësi përpunimi dhe ruajtja kryhet nëpërmjet algoritmeve që vërtetojnë autenticitetin e shortit, integritetin e të dhënave, sigurinë dhe auditimin e tyre.
2. Përdorimin e algoritme për autentifikimin e gjykatës që kërkon procesin e shortimit. Çdo gjykatë përdor “çelësa të ndarë” (shared key) për të gjeneruar kod unik, me një përdorim (One Time Password). Kjo procedurë synon garantimin e procedimit të mesazheve të dërguara vetëm nga gjykatat dhe çdo mesazh i tillë ka një autentifikim të paimitueshëm në rast të gjurmimeve në rrjet (Man In The Middle Attacks).
3. Ruajtjen e të dhënave të shortimeve në mënyrë historike dhe të plotë, të lidhura në mënyrë unike të paimitueshme me mesazhet sekuenciale, duke bërë procesin e auditueshëm dhe të dhënat e pa modifikueshme.

Për funksionimin e sistemit të shortimit janë kryer integrimet e nevojshme në sistemin ICMIS dhe ARK IT të çdo gjykate për realizimin e komunikimit të sigurt mes sistemeve. Parimet dhe teknologjia e përdorur për këtë sistem janë ato të "**Permissioned PoS blockchain**". Pjesëmarrësit (Gjykatat) firmosin dhe mundësojnë vlerësimin e vlefshmërisë së transaksioneve të gjeneruara nga ta. Vlerësimi i transaksioneve bëhet gjithashtu nga një qendrore (KLGG).

▫ **Përmirësimi i sistemit ICMIS pranë Gjykatës së Lartë**

Gjatë vitit 2023, ndër të tjera janë shtuar module të reja me qëllim shortimin e çështjeve pranë Gjykatës së Lartë për të balancuar ngarkesën e punës në raport me numrin e çështjeve sipas kategorive që paraqesin. Zhvillimi i këtij moduli është kryer duke ndjekur parimin e transparencës, shpërndarjen e barabartë dhe në mënyrë të rastësishme.

▫ **Përpunimi i të dhënave statistikore për sistemin ICMIS**

Me qëllim përpunimin e të dhënave statistikore është bërë e mundur gjenerimi në format EXEL i rezultatit të kërkimit në sistemin ICMIS, nëpërmjet filtrave të shtuar në rubrikat përkatëse. Me një klikim mund të afishohet lista e çështjeve në gjykim për një gjyqtar specifik dhe ofrohet mundësia e kërkimit të një çështjeje sipas një fjale kyçe të objektit të çështjes. Raporti përmbledhës i seancave të filluara me vonesë është përmirësuar dhe pasuruar me informacion dhe tanimë mund të gjenerohet lista e detajuar e çështjeve të cilat kanë filluar me vonesë sipas formatit të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

▫ **Aksesimi i vendimeve të gjykatave të shkallëve të ulëta nga gjykatat e apelit për sistemin ICMIS**

Në vijim të zhvillimit informatik të kryer për Gjykatën e Lartë gjatë vitit 2021, tanimë është i mundur aksesimi, nëpërmjet një rubrike të dedikuar në sistemin e menaxhimit të çështjeve ICMIS, i çështjeve të cilat kanë një vendim përfundimtar. Nëpërmjet kësaj rubrike mund të kërkohet me numrin e çështjes dhe pasi klikohet butoni “kërko” shfaqet vendimi i përfunduar i gjykatës.

Zhvillimi për aksesin e vendimeve, është vendosur në funksion gjatë vitit 2023 në dy gjykata, përkatësisht në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykatën Administrative të Apelit.

▫ **Anonimizimi automatik i të dhënave sensitive**

Në zbatim të detyrimeve ligjore që vijnë nga ligji Nr. 9887 dt.10/03/2008, ndryshuar me ligjin Nr.48/2012 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” si dhe rekomandimeve të Komisionerit për të Drejtën e Informimit Mbrojtjen e të Dhënave Personale, janë kryer përmirësime në lidhje me procesin e anonimizimi automatik të të dhënave sensitive, duke trajtuar algoritmin nëpërmjet teknikave të Machine Learning.

Përmes këtij zhvillimi teknik u garantua një ekuilibër konstruktiv që synon të rregullojw nga njëra anë nevojën e shtuar për transparencë dhe akses në gjyqësor dhe nga ana tjetrën mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

▫ **Transparenca dhe verifikimet në sistem**

Në portalin gjykata.gov.al është shtuar tek lloji i çështjes për çështjet civile “Padi me palë Gazetarë/Përfaqësues Mediash” dhe do të shfaqet e para në renditje dhe me sfond të veçuar. Referuar raportit të gjeneruar nga sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore rezulton se gjatë vitit 2023, janë paraqitur në total për gjykim 39 çështje të reja ku si palë janë gazetarë apo përfaqësues mediash dhe janë ankimuar 28 prej tyre.

▫ **Plotësimi i trupit gjykues elektronikisht në sistemin ARKIT**

Në sistemin elektronik që përdoret nga Gjykata e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë janë kryer zhvillime teknologjike me qëllim digjitalizimin e procesit të shortimit elektronik të kryesuesit ndërmjet anëtarëve të trupit gjykues. Për zhvillimet cituar sa më sipër është realizuar manuali mbi hapat që duhet të ndiqen nga përdoruesi për përdorimin e kësaj rubrike të re.

Lidhur me plotësimin me short të çështjeve kur gjyqtari në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues heq dorë, parashikohet të zhvillohet gjatë vitit 2024.

▫ **Përditësimi i pajisjeve KIOSK në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykatën e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.**

Gjatë vitit 2023 është bërë e mundur përshtatja e logjikës 'kiosk informuese' për sistemin ARKIT, kjo sepse zgjidhja që përdornin gjykatat e tjera të Republikës së Shqipërisë shërbente vetëm për sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore ICMIS.

Për këtë arsye janë kryer ndërhyrje specifike për të përkthyer "source code" dhe për ta adaptuar me sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore ARKIT, duke garantuar parimin e unifikimit të sistemeve TIK.

Çështje të tjera të rëndësishme dhe të trajtuara nga KPSAB-ja në lidhje me teknologjinë e informacionit të përdorur si nga vetë KLGJ-ja ashtu edhe nga gjykatat në vend me qëllim rritjen e efikasitetit apo cilësisë në ofrimin e shërbimeve për të gjithë aktorët apo përdoruesit e sistemit duke pasur në fokus sigurinë, transparencën, automatizimin dhe ofrimin e tyre në mënyrë elektronike (online), mund të përmbledhen si vijon:

🚧 Implementimi i infrastrukturës hardware për sistemin e regjistrimit audio/video në sallat e gjyqit të gjykatave, rritja e kapacitetit të arkivimit të materialeve audio/video dhe implementimi i teknologjisë për regjistrimin video të seancave gjyqësore.

Infrastruktura e re RDA/V (Regjistrimi Digjital Audio dhe Video) ka si qëllim rritjen e transparencës, efikasitetit, kontrollit dhe monitorimit të seancave gjyqësore. Aktualisht përdorimi i Sistemi RDA në Shqipëri dhe mbarëvajtja e përdorimit të tij mbështetet kryesisht në Kodet e Procedurës (Civile - neni 118 dhe Penale - neni 115).

Ky projekt i implementuar gjatë vitit 2023 ka bërë të mundur:

- Furnizimin me të gjithë elementët/ pajisjet fizike për realizimin e regjistrimit digjital audio dhe video në sallën e gjyqit sipas standardit të kërkuara nga programi i regjistrimit digjital audio-video.
- Instalimin dhe konfigurimin e pajisjeve kompjutera, kamera IP me programin e regjistrimit digjital audio video duke siguruar kualitet dhe qartësi të regjistrimit të sinjalit audio dhe video në formatet FHD dhe HD.
- Sigurimin e hapësirës fizike të mjaftueshme për regjistrimin digjital audio video në të tria nivelet: sallë gjyqi, dhomë server (NAS/SAN/DAS) dhe në vendndodhjen qendrore (NAS/SAN/DAS) si dhe konfigurimin dhe integrimin e saj me infrastrukturën aktuale duke ruajtur standardet më të mira në treg në nivel lokal (Salla-Gjykata) dhe në nivel qendror (KLGJ).
- Aksesimin nga përdoruesit e sistemit në regjistrimet audio, regjistrimet audio-video dhe shënimet audio të mbajtura me sistemin RDA në nivel lokal sallat gjyqi dhe në nivel NAS/SAN/DAS "storage" lokal (Dhomë Serveri) për të gjitha sallat e gjyqit.

🚧 Pas ngritjes dhe vënies në funksion të rrjetit të sigurve me qëllim shkëmbimin e të dhënave në mënyrë të sigurt të KLGJ me gjykatat është konfiguruar komunikimi VPN Site to Site

Në çdo rast suporti teknik për sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore, serveri i gjykatës aksesohet vetëm duke shfrytëzuar rrjetin e sigurt të KLGJ-së me gjykatat. Për çdo lidhje në serverat e institucionit është konfiguruar njoftimi automatik i cili sinjalizon në kohë reale përmes e-mail (Real time alert notifications), në adresën e nëpunësve që do të caktohen për ndjekjen e kontratës nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, si dhe duke vënë në dijeni përmes, njoftim automatik me e-mail, nëpunësin e IT-së të gjykatës, në të cilën po kryhet suporti teknik.

Njoftimi automatik sinjalizues me e-mail, përmban arsyen e detajuar përse punonjësi i suportit teknik nga kompania do të hyjë në server, si dhe kohën kur do të hyjë në server. Gjithashtu, në përfundim të lidhjes me serverin nga ana e ofruesit të shërbimit të suportit, në njoftimin automatik sinjalizues me e-mail do të përshkruhen koha e daljes nga serveri dhe veprimet që u kryen në serverin e gjykatës.

🚩 Ka vijuar puna në kuadër të projektit të digjitalizimit të arkivës gjyqësore.

Gjatë vitit 2023 janë digjitalizuar gjithsej: 6,272,694 fletë nga kodekset, 663,762 fletë nga regjistrat, 68,988 fletë nga numërorët dhe 68,096 fletë nga aktet e protokollit të shpërndara sipas gjykatave. Ndërkohë ka përfunduar procesi i digjitalizimit të arkivës për gjykatat:

1. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë;
2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë;
3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër;
4. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë;
5. Zyra e shërbimit, ish-Gjykata e Apelit Korçë;
6. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës;
7. Zyra e Shërbimit, ish-Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin;
8. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;

🚩 Ka filluar zbatimi i Regjistrit Elektronik të OJF-ve i cili bazohet në udhëzimet e ligjit 80/2021, “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”.

Bazuar në dispozitat ligjore¹¹ ka vijuar puna me qëllim përditësimin e Regjistrit Elektronik të Organizatave Jofitimprurëse, i cili do të funksionojë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Regjistri është funksional nga pikëpamja teknike dhe është duke u përditësuar me materialet e digjitalizuara të arkivës së regjistrit kombëtar të Organizatave Jofitimprurëse.

Procesi i digjitalizimit të dosjeve të OJF-ve ka përfunduar në masën 80%.

¹¹ Përkatësisht në nenin 61, pika 1, shkronja ‘ë’ dhe neni 97, pika 1, shkronja ‘c’, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika 2, dhe neni 50 pika 2 të Ligjit nr. 80/2021 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”, si dhe bazuar në vendimin nr. 35, datë 26.01.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor

Këshilli i Lartë Gjyqësorë gjatë vitit 2023 ka kryer zhvillimet e nevojshme me qëllim garantimin e procesit të ndërveprimit me institucionet e përfshira në proces¹², ndërsa është në pritje të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit për miratimin e protokollit të komunikimit midis regjistrat elektronik të OJF-ve dhe QKB-së si dhe mundësisë për të disponuar webservice-t të cilat do të shërbejnë për postimin e të dhënave të regjistrat elektronik të organizatave jofitimprurëse në sistemin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Harta e re gjyqësore

Bazuar në hartën e re të organizimit të gjykatave, janë kryer ndryshimet e nevojshme në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (ICMIS dhe ARKIT) dhe ka përfunduar procesi i migrimit të të dhënave nga gjykatat që ndërprejnë veprimtarinë në gjykatën pritëse. Po ashtu, janë marrë masat për të ndërhyrë në infrastrukturën hardëare (implementim i serverave dhe pajisjeve të rrjetit) në gjykatat të cilat nuk plotësonin kushtet për të hostuar të dhënat e sistemit të migruar.

Çdo ndryshim në sistemin e menaxhimit të çështjeve është reflektuar dhe në portalin gjykata.gov.al, duke garantuar pa ndërprerje dhënien e informacionit mbi çështjet gjyqësore si dhe pasqyrimin online të veprimtarisë së gjykatave pritëse.

Garantimi i funksionimit të pa ndërprerë i platformës M-Files gjatë vitit 2023.

Gjyqtarët janë mbështetur për plotësimin e formularit të integruar të vlerësimit nëpërmjet platformës së krijuar për këtë qëllim si dhe janë zhvilluar seanca trajnuese për të gjithë magistratët, nëpunësit e njësisë së vlerësimit të magistratëve dhe për të gjithë përdoruesit e tjerë të sistemit.

Në kuadër të informatizimit të proceseve të punës është kryer një zhvillim i ri, i cili mundëson gjenerimin e raporteve statistikore në sistemin M-files në lidhje me numrin e kërkesave për delegime (caktim gjyqtari) që u trajtuan në një vit të caktuar dhe sa gjyqtarë u caktuan për plotësimin e trupës gjyqësore sipas gjykatave, sipas vitit dhe sipas periudhës kohore specifike.

Gjithashtu, janë ndërtuar formate të cilat mundësojnë gjenerimin e raporteve statistikore në sistemin M-files nëpërmjet përdorimit të funksionalitetit kërkim me filtër, kërkim individual (emër mbiemër për një gjyqtar), ose për një periudhë kohore specifike, shpërndarja në cilën gjykatë është deleguar, dhe të dhënat e çështjes për të cilën është caktuar të gjykojë çështje të veçantë, në një gjykatë tjetër të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionet në mënyrë të përhershme.

¹² (AKSHI – E-Albania, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Qendra Kombëtare e Biznesit, Drejtoria e Taksave Vendore Tiranë, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, Instat dhe Agjencia e Inteligjencës Artificiale).

🚩 Materialet e paraqitura përpara bordit drejtues të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit (QTI) dhe vendimet e miratuara gjatë vitit 2023.

Gjatë vitit 2023, Qendra e Teknologjisë së Informacionit ka zhvilluar 14 mbledhje nëpërmjet së cilave janë miratuar 14 akte, ndër të cilat vlejné të përmenden:

- Vendimi nr. 5, datë 15.06.2023, përmes të cilit QTI ka vendosur ngritjen e grupit të punës, për hartimin e udhërrëfyesit për digjitalizimin e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri.
- Vendimi nr. 9, datë 26.10.2023, përmes të cilës është miratuar “Korniza e ndërveprimit për sistemin e drejtësisë në Republikën e Shqipërisë.”
- Vendimi nr.12 datë 22.11.2023, përmes të cilit është miratuar “Dokumentin teknik për standardet e dizenjimit dhe standardet e specifikimeve teknike të sistemit të ri të menaxhimit të veprimtarisë së Shkollës së Magjistraturës.”

Veprimtaria e Qendrës është mbështetur nga stafi, i cili përbëhet nga Drejtori Ekzekutiv dhe 3 specialistë të rekurruar gjatë vitit 2023, ndërsa mbeten për tu plotësuar edhe 2 vende të tjera vakante.

7. MENAXHIMI FINANCIAR NË FUNKSION TË ADMINISTRIMIT TË MIRË DHE EFIKAS TË VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT DHE GJYKATAVE

Gjatë vitit 2023, Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, ka ndjekur dhe zbatuar të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në lidhje me administrimin e buxhetit të grupit buxhetor Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ, QTI dhe Gjykatat), si në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e tij sipas legjislacionit për menaxhimin buxhetor.

KPSAB-ja, shqyrton, miraton dhe i propozon seancës plenare të KLGJ-së, për shqyrtim dhe miratim dokumentin e projektbuxhetin vjetor dhe afatmesëm të propozuar nga Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit, për grupin buxhetor Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ, QTI dhe Gjykatat), në përputhje me legjislacionin për menaxhimin buxhetor në fuqi.

Gjatë vitit 2023, Komisioni ka kryer administrimin, zbatimin, rishpërndarjen dhe monitorimin e fondeve të akorduara, duke u bazuar në situatën e vitit buxhetor dhe kërkesat e gjykatave për fonde shtesë, si dhe në mirë-menaxhimin e aktiveve të gjykatave të të gjitha nivele.

Për vitin buxhetor 2023, me ligjin nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, është miratuar buxheti i shtetit për vitin 2023, pjesë e të cilit është edhe buxheti për sistemin gjyqësor (grupi buxhetor Këshilli i Lartë Gjyqësor), i ndarë në tre programe;

- 🚩 Programi buxhetor 01110, “**Planifikim, Menaxhim dhe Administrim**”, ku përfshihen fondet buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor.

- ✚ Programi buxhetor 01140, “Mbështetje për Teknologjinë e Sistemit të Drejtësisë”, ku përfshihen fondet buxhetore për funksionimin e veprimtarisë së Qendrës së Teknologjisë së Informacionit (QTI)
- ✚ Programi buxhetor 03310, “Buxheti Gjyqësor”, ku përfshihen fondet buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së gjykatave në të tre nivelet.

Fondet buxhetore të sistemit gjyqësor, të rishikuara, së bashku me realizimin 12 mujor¹³ për vitin buxhetor 2023, paraqiten sipas pasqyrës së mëposhtme:

*Pasqyra
e fondeve buxhetore të miratuara për Sistemin Gjyqësor për vitin 2023*

000 lekë

Nr	Emërtimi	Buxheti i miratuar për vitin 2023	Ndryshime gjatë vitit 2023	Buxheti i rishikuar për vitin 2023	Realizimi për vitin 2023 në lekë	Realizimi për vitin 2023 në %
1.	Shpenzime paga	2,619,550	727,804	3,347,354	3,271,892	98%
2.	Shpenzime sig. shoqërore e shënd	319,150	26,000	345,150	321,750	93%
3.	Shpenzime operative	692,900	75,953	768,853	702,272	92%
4.	Shpenzime kapitale (Investime)	731,000	-344,400	386,600	337,324	87%
	Totali	4,362,600	485,357	4,847,957	4,633,238	96%

Gjatë vitit buxhetor 2023, buxheti i sistemit gjyqësor është rishikuar disa herë, duke u shtuar dhe pakësuar në shumën absolute prej 485,357 mijë lekë¹⁴, si më poshtë vijon:

- Akordimi i fondit të veçantë nga MFE me Udhëzimin Plotësues nr. 2, datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, dhe mbështetur në Vendimin nr. 79 datë 16.2.2023 i KLGJ për detajimin e fondit të veçante në shumën 4,500,000 lekë, respektivisht në programin 01110 - “Planifikim, menaxhim dhe administrim” në shumën 1,200,000 lekë, programin 01140 - “Mbështetje për Teknologjinë e Sistemit të Drejtësisë”, në shumën 100,000 lekë dhe në programin 03310 - “Buxheti Gjyqësor”, në shumën 3,200,000 lekë.
- Akordim fondi shtese me VKM nr. 437, datë 19.07.2023, “Për shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2023 për disa institucione të pavarura të krijuara me ligj”, në shumën 300,000 mijë lekë në programin 03310 “Buxheti Gjyqësor”, në shpenzime korrente.
- Akordim fondi shtesë me VKM nr. 755, datë 20.12.2023 “Për një shtesë në buxhetin e miratuar për vitin 2023 për disa institucione të pavarur të krijuara me ligj”, në shumën 350,000 mijë lekë nga të cilat; në programin 01110 “Planifikim, menaxhim dhe administrim” në shumën 20,000 mijë lekë dhe në programin 03310 “Buxheti Gjyqësor” në shumën 330,000 mijë lekë, në shpenzime korrente.

¹³ Për shkak se thesari deri më datë 23.01.2023, nuk ka bërë ende rakordimin përfundimtar për vitin 2023, niveli i realizimit 12-mujor për fondet buxhetore të sistemit gjyqësor mund të ndryshojë.

¹⁴ Nga të cilat në shpenzime paga është shtuar në shumën 727,804 mijë lekë, shpenzime sigurime shoqërore është shtuar në shumën 26,000 mijë lekë, shpenzime operative është shtuar në shumën 75,953 mijë lekë dhe shpenzimet kapitale janë pakësuar në shumën 344,400 mijë lekë.

- Pakësimi i fondi me Aktin Normativ nr. 6, datë 14.12.2023 në shumën 344,400 mijë lekë në programin 03310 “Buxhetit Gjyqësor”, në shpenzime kapitale (Investime).
- Akordim i fondi shtese me VKM nr. 834, datë 28.12.2023 “Për një ndryshim në Vendimin nr. 929, datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, të ndryshuar, dhe për shtesë të fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2023, miratuar për disa institucione”, në shumën 920 mijë lekë, në programin 03310 “Buxheti Gjyqësor”.
- Akordim i fondi shtese me VKM nr. 795, datë 28.12.2023” Për shpërblimin e punonjësve të qeverisjes qendrore në procesin e shqyrtimit analitik të ACQUIS (Screening), në kuadër të procesit të negociatave me Bashkimin Evropian”, në shumën 2,084 mijë lekë, respektivisht 1,526 mijë lekë në programin 03310 “Buxheti Gjyqësor” dhe 559 mijë lekë në programin 01110 “Planifikim, menaxhim dhe administrim”.

Gjithashtu, janë miratuar rishpërndarje të fondeve buxhetore në shpenzime korrente dhe shpenzime kapitale (investime, në programin 03310 “Buxheti Gjyqësor”¹⁵. Këto rishpërndarje fondesh janë kryer për plotësimin të nevojave sipas kërkesave të gjykatave.

Fondet buxhetore të miratuara për vitin 2023, për sistemin gjyqësor, i ndarë sipas programeve buxhetore, paraqitet sipas pasqyrës së mëposhtme:

*Pasqyra
e fondeve buxhetore të miratuara sipas programeve buxhetore, për vitin 2023*

000 lekë

Kodi	Emërtimi i programit	Shpenzim e Paga	Shpenzime Sig. shoqërore	Shpenzi me operativ e	Shpenzim e kapitale (investim)	Totali fondeve
	01110 Planifikim, Menaxhim, Administrim	233,559	28,500	76,653	15,000	353,712
	01140 QTI	9,650	1,650	1,700	0	13,000
	03310 Buxheti Gjyqësor	3,104,145	315,000	690,500	371,600	4,481,245
29	Këshilli i Lartë Gjyqësor	3,347,354	345,150	768,853	386,600	4,847,957

I. Programi buxhetor 01110, “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”, ku përfshihen fondet buxhetore për funksionimin e veprimtarisë së institucionit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Fondet buxhetore të miratuara për programin “Planifikim, Menaxhimi dhe Administrim”, sipas emërimit të shpenzimeve, paraqiten sipas pasqyrës së mëposhtme:

¹⁵ Në zbatim të vendimeve nr. 232 datë 11.05.2023, nr. 447 datë 24.07.2023, nr. 362 datë 13.07.2023, nr. 640 datë 26.10.2023 dhe nr. 495 datë 21.09.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor,

Pasqyra
e buxhetit të miratuar për programin 01110 për vitin 2023

000 lekë

Nr	Emërtimi	Buxheti i miratuar për vitin 2023	Ndryshime gjate vitit 2023	Buxheti i rishikuar për vitin 2023	Realizimi për vitin 2023 në lekë	Realizimi për vitin 2023 %
1	Shpenzime paga	209,000	24,558	233,558	227,194	97%
2	Shpenzime sig. shoqërore e shënd	27,500	1,000	28,500	26,072	92%
3	Shpenzime operative	73,200	3,453	76,653	54,628	72%
4	Shpenzime kapitale (Investime)	15,000	0	15,000	12,788	85%
	Totali	324,700	29,011	353,711	320,480	91%

Fondet buxhetore në programin “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi”, janë realizuar në masën **91%**, ose në vlerë absolute **320,480 mijë lekë**.

1. Shpenzime personeli¹⁶

Buxheti i miratuar në shpenzime personeli është **236,500 mijë lekë**, i ndarë përkatësisht në shumën 209,000 mijë lekë në paga dhe në shumën 27,500 mijë lekë në sigurime shoqërore. Ky fond është përlllogaritur dhe miratuar për **128 punonjës**. Realizimi fondeve të rishikuara në shpenzime personeli është **në masën 97%**, për shkak të mos plotësimit 100% të strukturës organizative të KLGJ-së.

2. Shpenzime operative

Lidhur me shpenzimet për mallra e shërbime të tjera (operative) është miratuar një fond në shumën **73,200 mijë lekë**. Në këtë fond u përfshinë nevojat në shpenzimet operative për aktivitetin e përditshëm të KLGJ-së, referuar kërkesave të përcaktuara në fazën e projektbuxhetit sipas zërave të shpenzimeve si dhe realizimit të vitit 2022.

Realizimi i fondeve të rishikuara në shpenzimeve operative është në masën **72%**. Në këtë zë të shpenzimeve janë realizuar shpenzimet për aktivitetin e përditshëm të institucionit të KLGJ-së.

3. Shpenzime Kapitale

Buxheti i miratuar në shpenzime kapitale (investime) ishte në shumën **15,000 mijë lekë**. Në këtë fond ishin përfshirë kryesisht nevojat për pajisje teknologjike dhe rikonstruksion Realizimi i shpenzimeve kapitale është kryer në **masën 85 %**.

¹⁶ 1. Ku përfshihen paga dhe sigurime shoqërore

II. Programi buxhetor 01140, “Mbështetje për Teknologjinë e Sistemit të Drejtësisë”¹⁷

Në këtë program Fondet buxhetore të miratuara për programin “Mbështetje për Teknologjinë e Sistemit të Drejtësisë”, sipas emërimit të shpenzimeve, paraqiten sipas pasqyrës së mëposhtme:

*Pasqyra
e buxhetit të miratuar për programin 01140 për vitin 2023*

Nr	Emërtimi	Buxheti i miratuar për vitin 2023	Ndryshime gjate vitit 2023	Buxheti i rishikuar për vitin 2023	000 lekë	
					Realizimi për vitin 2023 në lekë	Realizimi për vitin 2023 në %
1	Shpenzime paga	10,850	-1,200	9,650	3,666	38%
2	Shpenzime sig. shoqërore e shënd	1,650	0	1,650	508	31%
3	Shpenzime operative	400	1,300	1,700	1.043	61%
4	Shpenzime kapitale (Investime)	0	0	0	0	0
	Totali	12,900	100	13,000	5,217	40%

Fondet buxhetore për vitin 2023, për QTI-në janë alokuar vetëm në shpenzime korrente dhe janë realizuar në masën 40% për shkak të mosplotësimit të strukturës organike të saj.

Projekti më madhor i Qendrës në bashkëpunim të ngushtë edhe me Këshillin e Lartë Gjyqësor, ka qënë dhe mbetet ndërtimi i një sistemi të ri të integruar të menaxhimit të çështjeve gjyqësore. Ky sistem do i shërbejë në afat-gjatë dhe në mënyrë strategjike të gjithë sistemit të drejtësisë duke ofruar automatizim më të lartë dhe do të mbështesë rrjedhën e punës brenda gjykatave duke ndikuar drejtëpërdrejtë në rritjen e efikasitetit, aksesit në drejtësi, respektimin e afateve kohore, transparencës, raportimit statistikor dhe llogaridhënies.

Kjo përpjekje e Këshillit filluar që në vitin 2019, konsiston jo vetëm në negociimin e mbështetjes buxhetore nga buxheti i shtetit, arritur me miratimin e buxhetit për vitin 2023, por edhe në mbledhjen e fondeve nga donatorë si Ambasada Suedeze dhe fondet IPA. Kjo për shkak se ndërtimi i një sistemi të ri është një projekt i kushtueshëm nga pikëpamja financiare e cila kërkon bashkimin e disa burimeve financimi.

Gjatë vitit 2023, Këshilli ka bërë përpjekje maksimale në këtë drejtim dhe në bashkëpunim me QTI-në janë hartuar dhe miratuar dokumentat kornizë për ndërtimin e sistemit të ri të integruar të menaxhimit të çështjeve gjyqësore për të gjithë sistemin e drejtësisë. Gjithashtu, është hartuar dhe dërguar për miratim në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financës, Marrëveshja me Ambasadën Suedeze, e cila garanton mbështetje financiare në funksion të ndërtimit të sistemit të ri.

¹⁷ Në këtë program përfshihen fondet buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 972, datë 02.12.2020 “Për organizimin, funksionimin e përcaktimin e kompetencave të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë”.

Vlen të theksohet se, me miratimin e projekt-buxhetit për vitin 2024, fondet buxhetore të parashikuara dhe të akorduara me buxhetin e vitit 2023 për ndërtimin e një sistemi të ri nuk janë aprovuar. Ndërsa edhe marrëveshja me Ambasadën Suedeze vazhdon të mbetet në pritje të një konfirmimi nga struktura e lartpërmendur.

Për rrjedhojë, Këshilli është në proces koordinimi me të gjithë aktorët potenciale që të do mundësojnë realizimin e këtij projekti në të ardhmen e afërt.

III. Programi buxhetor 03310, “Buxheti Gjyqësor”, ku përfshihen fondet buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së gjykatave në të gjitha nivelet

*Pasqyra
e buxhetit të miratuar për programin 03310 për vitin 2023*

000 lekë

Nr	Emërtimi	Buxheti i miratuar në fillim të vitit 2023	Ndryshime gjatë vitit 2023	Buxheti i rishikuar 2023	Realizimi për vitin 2023 në lekë	Realizimi për vitin 2023 në %
1	Shpenzime paga	2,399,700	704,445	3,104,145	3,041,033	98%
2	Shpenzime sig shoqërore e shënd	290,000	25,000	315,000	295,169	94%
3	Shpenzime operative	619,300	71,200	690,500	646,803	95%
4	Shpenzime kapitale (Investime)	716,000	- 344,400	371,600	324,536	87%
	Totali	4,025,000	456,245	4,481,245	4,307,541	96%

Fondet buxhetore të rishikuara në programin “Buxheti Gjyqësor”, për vitin buxhetor 2023, janë realizuar në masën **96%**.

1. Shpenzime personeli¹⁸

Buxheti i miratuar në shpenzime personeli është në shumën **2,689,700 mijë lekë**, i ndarë në shumën 2,399,700 mijë lekë në paga dhe në shumën 290,000 mijë lekë në sigurime shoqërore.

Buxheti në shpenzime personeli në këtë program është përlogaritur, mbështetur në numrin e plotë të punonjësve sipas strukturave organike për të gjitha gjykatat dhe nivelit të pagave në përputhje me legjislacionin në fuqi për magistratët dhe për administratën gjyqësore.

Realizimi i fondeve të rishikuara në shpenzime personeli është në masën **97 %**. Numri faktik i punonjësve në gjykatat e të gjitha niveleve, në fund të vitit 2023, është **1,363 punonjës** kundrejt **1,615 punonjës sipas strukturës organizative**. Konstatohet se gjatë vitit 2023 ka **252 punonjës më pak** në sistem nga të cilët: **79 janë magistratë**, (mungesa e të cilëve vjen për shkak të shkarkimit, dorëheqjes ose mosplotësisimit të vendeve të lira) dhe **173 të tjerë në administratën gjyqësore**. Këto mungesa nuk ka qenë e mundur të plotësohen brenda vitit 2023.

¹⁸ Ku përfshihen pagat dhe sigurimet shoqërore

2. Shpenzime operative

Buxheti i miratuar në shpenzime operative për vitin 2023 është në shumën **690,500 mijë lekë**, ndërkohë që **realizimi tyre është në masën 95%**.

3. Shpenzime kapitale (Investime) për programin 03310 “Buxheti Gjyqësor”

Buxheti i miratuar për këtë program ishte në shumën prej **716,000 mijë lekë**. Këto fonde janë ndarë sipas projekteve të mëposhtme:

Pasqyra

*e fondeve në shpenzime kapitale (investime) sipas projekteve, për programin 03310, për vitin 2023
000 lekë*

Kodi i projektit	Emërtimi i projektit	Fondet buxhetore 2023	Rishikim buxheti	Realizimi për vitin 2023 në lekë	Realizimi për vitin 2023 në %
18AD801	Blerje pajisje zyre	189,100	15,700	14,119	95%
21AC501	Blerje software për gjykatat	361,800	86,841	76,982	89%
21AC401	Blerje pajisje elektronike	20,000	193,100	186,991	97%
M290075	Blerje mjete motorike	30,000	26,300	26,290	100%
M290068	Ndërtim i ri dhe rikonstruksion i plotë	56,500	49,059	19,854	40%
M290066	Studime dhe projekttime	58,600	600	300	50%
	Totali	716,000	371,600	324,536	87%

Realizimi i fondeve të rishikuara në shpenzime kapitale për programin 03310 është në masën **87%**. Në këtë realizim një ndikim të madh ka dhe mos çelja e fondeve buxhetore nga Ministria e Financave, në kodin e projektit blerje software për gjykatat, gjatë vitit buxhetor, fonde të cilat u pakësuan më pas me Aktin Normativ nr. 6, datë 14.12.2023, në shumën prej 344,400 mijë lekë.

Për sa më sipër, sikurse evidentohet edhe nga analiza raportuese e detajuar, **realizimi i fondeve buxhetore për vitin 2023, në sistemin gjyqësor, rezulton në masën 96 %**, i cili sipas grup shpenzimeve paraqitet si vijon:

- ✚ Në shpenzime paga, në masën 98 %,
- ✚ Në shpenzime sigurime shoqërore dhe shëndetësore, në masën 93 %,
- ✚ Në shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera (operative), në masën 92 %,
- ✚ Në shpenzime kapitale (investime), në masën 87 %.

Si përfundim, gjatë vitit buxhetor 2023, si viti i parë i implementimit të hartës së re gjyqësore dhe në përputhje dhe me realizimet e sipërpërmendura, KPSAB-ja ka dëshmuar një performancë të lartë duke reaguar me shpejtësi ndaj nevojave në sistemin gjyqësor dhe duke mundësuar një vendimmarrje të drejtë dhe ligjore të vetë Këshillit në funksion të menaxhimit të fondeve buxhetore me efektivitet dhe efikasitet.

Megjithatë duhet përmendur fakti se gjatë këtij viti financiar, Këshilli është ndeshur me pengesa të shumta në lidhje me aksesimin e fondit buxhetor të besuar dhe miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Ky fond edhe pse disbursuar në llogarinë e Këshillit ka qenë i bllokuar në disa raste nga Ministria e Financave në kundërshtim me çdo akt rregullativ që normon përdorimin e fondeve buxhetore, duke na venë në vështirësi të dukshme në përballimin e nevojave ekonomike dhe duke humbur kohë e punë të burimeve njerëzore me qëllim zgjidhjen e tyre.

Miratimi i hartës gjyqësore të pa shoqëruar me faturën financiare ka krijuar vështirësi në zbatimin e saj e shoqëruar kjo me një degradim të të gjithë infrastrukturës gjyqësore, të cilat kanë mbetur fosile ndërtimore të së kaluarës, pa mundësisë së saj për të akomoduar gjyqtarët, nëpunësit gjyqësor, aksesin në gjykate, krijimin e pengesave me zgjerimin e trupës gjyqësore atje ku ngarkesa e çështjeve është tejte kapacitetit të përballimit njerëzor, mos vënies në disponim të fondeve për riparimin e menjërhershëm të godinave, si dhe mungesa e vazhdueshme e trojeve për ndërtim dhe zgjerim gjykatash. Për të përballuar këtë vështirësi shpesh herë kemi përdorur fonde të miratuar për përdorim nga njësitë e administrimit të buxhetit gjyqësor dhe privuar këto të fundit nga kryerja e investimeve.

Për rrjedhojë një situatë e tillë na detyron të rekomandojmë mundësinë e propozimeve për ndryshimin e ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” ku Kuvendi i Shqipërisë të jete i vetmi autoritet publik me natyrë konsultuese e vendimmarrës në lidhje me miratimin e buxhetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Vetëm në këtë mënyrë pavarësia e pushtetit gjyqësor do të garantohet jo vetëm *de juro* (parimisht) por edhe *de facto* (faktikisht).

8. PROJEKTE TË KOMISIONIT TË PLANIFIKIMIT STRATEGJIK, ADMINISTRIMIT DHE BUXHETIT

Në këtë rrugëtim, Këshilli i Lartë Gjyqësor është mbështetur nga asistencë e partnerëve ndërkombëtarë si Këshilli i Evropës, përmes projektit “Mbështetje për Efikasitetin e Drejtësisë – SEJ III” si dhe Komisionit Evropian për Efiçencën e Drejtësisë (CEPEJ), si dhe Agjencisë Austriake për Zhvillim përmes projektit për “Zgjerimin dhe fuqizimin e sistemit të ndërmjetësimin në Shqipëri”. Kontributi i partnerëve ndërkombëtar është fokusuar kryesisht në:

- ✚ Pilotimi i pyetësorit online për kënaqësinë e përdoruesve të gjykatës, i cili ka filluar zbatimin në vitin 2022 për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ka vijuar me zbatimin në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë. Ky pyetësor është jo vetëm detyrim ligjor, parashikuar në nenin 94, pika 5, shkronja “a” e Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, por një nevojë e sistemit gjyqësor për të kuptuar cilësinë e shërbimeve të ofruara ndaj qytetarit dhe profesionistëve të drejtësisë. Kjo iniciativë e Këshillit të Lartë Gjyqësor u mundësua me mbështetjen e projektit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës “Forcimi i

cilësisë dhe efikasitetit të drejtësisë në Shqipëri (SEJ IV)”, pjesë e programit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës “Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë” – Faza III.

Për vitin 2023 vlen të përmendet se Aksioni SEJIV ka vijuar të mbështes KLGJ-në në lidhje me rritjen e efikasitetit të sistemit gjyqësor, përmes:

- ✚ Trajnimit të administratës gjyqësore; 150 pjesëmarrës nga administrata gjyqësore (përfshirë kancelarë, këshilltarët ligjorë dhe sekretarët gjyqësorë) nga të gjitha gjykatat e shkallës së parë dhe apelit të juridiksionit të përgjithshëm u trajnuar mbi mjetet e CEPEJ-it për menaxhimin e kohës gjyqësore me synim rritjen e mbështetjes së administratës.
- ✚ Zhvillimit të 2 seminareve trajnuese për gjyqtarët e medias dhe stafin e marrëdhënieve me publikun.
- ✚ Ofrimit të rekomandimeve për “Udhëzuesin standard për komunikimin e gjykatës me publikun dhe median” si dhe Kornizën e Ndërveprimit për Sektorin e Drejtësisë në Shqipëri”.

Gjithashtu, gjatë vitit 2023 ka vijuar zbatimi i dy nismave të ndërmarra më herët nga Këshilli që kanë lidhje me:

- ✚ Projektit për komunikimin online mes Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Prokurorisë dhe Dhomës së Avokatisë, projekt, i cili ka mundur propozimin e zgjidhjeve teknike për zhvillimin dhe ofrimin e shërbimeve programatike, të cilat lehtësojnë komunikimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me aktorët e jashtëm të përfshirë në Procesin e Menaxhimit të Çështjeve të Gjykatës.
- ✚ Zhvillimin e sistemit elektronik të burimeve njerëzore për KLGJ-në dhe administratën gjyqësore, e cila ka në fokus automatizimin e sistemeve të punës për menaxhimin e burimeve njerëzore.

9. ANGAZHIME PËR TË ARDHMEN

Në kuadrin e kryerjes së bilancit për vitin 2023 dhe duke qenë i vetëdijshëm për rolin dhe funksionet e tij por mbi të gjitha sfidat që paraqet e ardhmja, Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, do të vijojë punën e tij me përgjegjësi e përkushtim edhe gjatë vitit 2024. Duke marrë në konsideratë karakterin e vazhdueshëm të prioriteteve të Këshillit të Lartë Gjyqësor që reflektohet edhe në ato të Komisioneve të Përhershme, disa nga objektivat e Komisionit për Planifikim Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit për vitin 2024 janë vazhdim i prioriteteve të mëparshme. Përkatësisht, për vitin 2024 KPSAB-ja angazhohet maksimalisht në realizimin e objektivave si më poshtë vijon.

1. Rishikimin dhe plotësimin e kuadrit ligjor/nënligjor përmes hartimit dhe miratimit të akteve në funksion të rritjes së pavarësisë, efikasitetit dhe performancës së sistemit gjyqësor, me fokus përmirësimin e cilësisë së shërbimeve gjyqësore për publikun.

2. Vazhdimin e zbatimit të reformës për nëpunësin civil gjyqësor përmes zbatimit të procedurave transparente dhe meritokratike të rekrutimit dhe finalizimit të paketës së akteve të nevojshme për mirëfunksionimin dhe fuqizimin e kapaciteteve profesionale të administratës civile gjyqësore.
 - Hartimi dhe miratimi i rregullores për procedurat disiplinore për nëpunësin civil gjyqësor.
 - Hartimi dhe miratimi i rregullores për formimin profesional të nëpunësve civilë gjyqësorë.
 - si dhe zhvillimi i vlerësimit të performancës së nëpunësve civilë gjyqësorë.
3. Hartimin e kërkesave buxhetore realiste si për vitin e ardhshëm dhe për buxhetin afatmesëm të sistemit gjyqësor në përputhje me monitorimin tashmë të zbatimit të Hartës së Re Gjyqësore dhe impaktit të saj.
 - Sigurimin e një komunikimi të vazhdueshëm me qëllim identifikimin e nevojave për burime financiare dhe burime njerëzore në sistemin gjyqësor.
4. Menaxhimin e fondeve buxhetore të alokuara me efikasitet dhe efektivitet për sistemin gjyqësor, përfshirë KLGJ-në, QTI-në dhe gjykatat dhe ndjekja e monitorimi i tyre.
 - Miratimi i rregullores së menaxhimit të aktivëve për të gjithë sistemin gjyqësor, sipas legjislacionit për menaxhimin e aktivëve në sektorin publik
5. Monitorimin permanent të nevojave të sistemit gjyqësor si për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit aktual të menaxhimit të çështjeve.
6. Fuqizimin e përpjekjeve për të vijuar rritjen e transparencës mbi sistemin gjyqësor përmes, ndër të tjerave, edhe zhvillimeve teknologjike dhe digjitalizimit të shërbimeve gjyqësore.
7. Rritja e kapaciteteve të infrastrukturës IT lidhur me menaxhimin e rrezikut të sigurisë kibernetike, duke identifikuar dhe adresuar rreziqet potenciale dhe duke pasur një plan të përgatitur për rikuperim, si dhe marrjen e masave për identifikimin dhe përballimin e incidenteve të mundshme kibernetike.
8. Forcimin e bashkëpunimit me donatorët dhe projektet e ndihmës së huaj me qëllim sigurimin e fondeve të nevojshme për zhvillimin e një sistemi të ri e bashkëkohor të teknologjisë së informacionit për sistemin e drejtësisë.